Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 1053, 1072, 1080, 1083, 1089, 1097/20
Datë/Datum. 28.01.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1053/20
1072/20
1080/20
1083/20
1089/20
1097/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: "Ballkan Petrol"SH.P.K-Ferizaj LOT 4:me numër te protokollit 1053/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit :Furnizimi dhe Instalimi i Ns gis ,ais Trandsformatoreve Energjitike dhe LP Lot 4 "Furnizimi dhe Instalimi i informatorëve te fuqisë 40MVA ne NS 110 35 10 (20) kv Fushë Kosovë dhe NS 220 35 10 (20)kv Malishevë, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës për Lot 4 është OE HAEM ENER ELEK.ELEKT. MUHEN.DANIS .INS TAAH.IÇ VE DIS TIC .SAN.LIMIT . SIRKETI Dega në Kosove; ASTOR TRANSFORMATOR , ne vlere prej 1.465.849.10€; sipas ankesës së ankesës së EO: "EL Power" & "AL Fokus"SH.P.K-Tiranë, me numër te protokollit: 1072/20 për Lot 4;sipas ankesës se OE "Electra"SH.P.K-Graqanicë, me numër te protokollit 1080/20, për LOT 3, kundër njoftimit për dhënie te kontratës "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, LOT 3, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës për LOT 3 është OE " ENBi POWER" SH.P.K. Dega në Kosovë, në vlere prej 3.281.421.87€.;sipas ankesës se OE OE: "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"D.D-Zagrep, me numër te protokollit 1083/20 për Lot 1,kundër njoftimit per dhnie te kontrates ku për Lot 1 është rekomanduar për dhënie te kontratës OE "ABB POWER Grids Zagreb ne vlere prej 4,665.967.55€; sipas ankesës se OE OE : "Doko"SH.P.K-Elbasan, me numër te protokollit 1089/20 për Lot 3,te parashtruar kundër njoftimit per dhënie te kontrates ku i rekomanduar për dhënie te kontratës për LOT 3 është OE " ENBI POWER" SH.P.K. Dega në Kosovë, në vlere prej 3.281.421.87€.;sipas ankesës se OE: "G3 Inxhiniering"SH.P.K,& "Monten LLC-Fushë Kosovë, me numër te protokollit 1097/20, për Lot 3 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës për LOT 3 është OE " ENBi POWER" SH.P.K. Dega në Kosovë, në vlere prej 3.281.421.87€., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregu-KOSTT "SH.A, më datën: 25.01.2021, mori këtë:

VENDIM

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Ballkan Petrol" SH.P.K-Ferizaj si dhe GEO: "EL Power" & "AL Fokus"SH.P.K-Tiranë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 4 me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1 , iniciuar nga AK –KOSTT SH.A,

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie te kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 4 me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1 , iniciuar nga AK KOSTT SH.A, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim** për **LOT 4**.

III.APROVOHET, si e pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Electra"SH.P.K-Graqanicë, ankesa e operatorit ekonomik "Doko"SH.P.K-Elbasan dhe "G3 Inxhiniering"SH.P.K,& "Monten LLC-Fushë Kosovë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 3 me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga AK -KOSTT SH.A,

IV. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull : "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga AK-KOSTT SH.A, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim** për **LOT 3**.

V.APROVOHET, si e pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: OE: "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"D.D-Zagrep, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 1 me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga AK -KOSTT SH.A,

VI. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull : "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 1 me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga AK-KOSTT SH.A, **vërtetohet** për **LOT 1**.

VII. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

VIII .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

IX. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik: "Ballkan Petrol"SH.P.K-Ferizaj, "Electra"SH.P.K-Graqanicë & "Doko"SH.P.K-Elbasan, "G3 Inxhiniering"SH.P.K,& "Monten LLC-Fushë KosovëS, "EL Power" & "AL Fokus"SH.P.K-Tiranë, & "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"D.D-Zagrep i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

X. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: "Ballkan Petrol"SH.P.K-Ferizaj LOT 4: si dhe GEO: "EL Power" & "AL Fokus"SH.P.K-Tiranë për Lot 4, & "Electra"SH.P.K-Graqanicë për Lot 3, & OE: "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"D.D-Zagrep për Lot 1, si dhe OE : "Doko"SH.P.K-Elbasan për Lot 3, & OE: "G3 Inxhiniering"SH.P.K,& "Monten LLC-Fushë Kosovë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 04.12.2020, me nr. 1053/2020, me 09.12.2020 me nr. 1072/20 ,dhe me datë 10.12.2020 me nr. 1080/20, dhe me datë 10.12.2020 me nr. 1083/2020,dhe me datë 11.12.2020, me nr.1089/20, dhe me datë 14.12.2020 me nr.1097/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS Transformatorëve Energjetik dhe LP" me nr. të prokurimit: KOSTT-20-4505-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregu-KOSTT "SH.A, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6 , 7 ,28 , 59 , si dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 41.parag 15 , 39.parag.8 i RRUOPP-së te ankesa me nr. 1053/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: dispozitat e LPP-së dhe RRUOPP-së pa i theksuar se cilat nene dhe dispozita janë shkelur , te ankesa me nr. 1072/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 29 ,59 ,si dhe nenin 60 të LPP-së , te ankesa me nr. 1080/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 , 59 , 60 , si dhe nenin 68 të LPP-së ,te ankesa me nr. 1083/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 2 , 6 , 7 , 27 , 28 , 59 , 65 , 71 , si

dhe nenin 72 të LPP-së ,si dhe nenin 39 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 1089/20.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 7 , 59 , 60 , 64 , si dhe nenin 69 të LPP-së ,te ankesa me nr. 1097/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

1- Operatori Ekonomik "HAEM Enerji Elektrik-dega në Kosovë dhe ASTOR Transformers-Turqi" (në tekstin e më tutjeshëm ***OE HAEM & ASTOR)*** (ofertë e cila është rekomanduar për kontratë)

- Nga qasja në dokumente kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues / Komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave conform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos I trajtuar ofertat në menyrë të barabartë sepse neve na kanë eliminuar me arsytimin se nuk e kemi plotësuar çmimin te kpozicioni 1 te "Programi 2"-punet inxhinierike për një vlerësim simbolike rreth 2 apo 3 mijë euro pa gjetur asnjë fakt tjeter që na mungon në ofertën tonë, ndërsa ka rekomanduar për kontratë grupin e OE HAEM & ASTOR ku nëse merret diferenca e çmimit si dhe kapitalizimin obligativ (të cilin do ta elaborojmë më vonë) del se AK ka shperblyer me kontratë një OE I cili ka çmim më të lartë rreth 84,748.00 € në ofertë financiare si dhe në kapitalizimin e humbjeve obligativ rreth 182,000.00€ ku së bashku në total 84,748.00 € + 182,000.00€ = 266,748.00 € (çmimi dhe kapitalizimi total), në krahasim me oferten financiare të dorëzuar nga kompanai jonë Ballkan Petrol SHPK.

Nëse e marrim këtë diferencë të çmimit, si është e mundur që kompania e jonë të eliminohet për një pike të vetme ndërsa AK të rekomandon për kontratë OE HAEM & ASTOR pa analizuar dhe konstatuar mangësitë e shumta që ka në ofertën financiare si dhe në dëshmitë tjera tëc ilat nuk i ka conform kërkesave dhe dëshmive të parashtruaranga AK në njfotimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues sqarone se operatori ekonomik ankues është elimnuar sepse nuk e ka plotësuar çmimin tek pozicioni 1 te "Programi 2"- pozicioni 1." Analiza e shpimeve te tokes dhe pergatitja e terrenit "– për ketë nuk ka ofruar çmim.Mirëpo, Autoriteti Kontraktues / Komisioni i vlerësimit duhet të bej vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke i trajtuar të gjithë OE në menyrë të barabartë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.2

Pretendimi ankimore ka të bej me: -Tek tabela e përshkrimit të çmimeve, pjesa elektrike, kolona "*construction/erection, commissioning*", pozicioni 1.2; 2.2; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 4.1; 4.2; 4.3; 4.4, si dhe te pjesa e punimeve inxhinierike, kolona e punëve, pozicioni 1, OE HAEM & ASTOR nuk ka dhënë çmim fare

dhe për pozicionet që kanë qenë obligative të plotësohen, OE HAEM & ASTOR nuk i ka plotësuar.

Përçudi ne si OE eliminohemi vetëm për njëpozicion, kurse OE ir ekomanduar për kontratë edhe pse nuk ka plotësuar tabelat që kanë qenë obligative në 11 pozicione (rubrikë e çmimeve) I njejti propozohet të shpërblehet me kontratë.

Më poshtë paraqesim disa pjesë të tabelave respektivisht të ofertes te pozicioni 1 të OE HAEM & ASTOR e cila nuk e ka plotësuar tabelën "Programi 2" në pozicioinin 1 "Analiza e shpimeve të tokës" ka dhënë çmim, ndërsa në të njejtin pozicion " Përgaditja e terenit" , e cila është punë, nuk ka dhënë çmim fare. Për të njejtin detal ne jemi eliminuar duke e arsyetuar se është në kundërshtim me nenin 39.8 të RRUOPP.

Eksperti shqyrtues sqarone se tabela e përshkrimit të çmimeve, pjesa elektrike, kolona ***"construction/erection, commissioning EURO"***, përpozicionet: 1.2; 2.2; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 4.1; 4.2; 4.3; 4.4, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë çmim për pozicionet e lartë cekura, është në kopetencën e autoriteti kontraktues të sqarojë lidhur me përshkrimin e çmimeve pasi ka paqartësi rreth kësaj, të cilat pretendime nuk i ka shqyrtuar edhe në ankesën për Ri-shqyrtim te operatorit ekonomik ankues, poashtu autoriteti kontraktues e eleminon operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se të "Progarmi 2" Programi 2"- pozicioni 1. "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergatitja e terrenit",i cili është elimnuar pasi nuk ka ofruar çmim për ketë pozicion, ndërsa për të njejtin pozicion operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotsuarkolna "Work/EURO", AK- komisioni i vlersimit nuk ka vepruar konform nenin 59, të LPP, gjatë procesit të vlersimit, ekzaminimit dhe krahsimit të ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Po ashtu, Sipas Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik - 41.15 Ne rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet qe të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro. 1. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet. 2. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.AK-ja, komisioni i vlersimit nuk ka berë trajtim të barabartë të operatorve eknomik. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.3

Po ashtu OE HAEM & ASTOR në ofertën e tij financiare ka bërë gabim në llogaritje të çmimeve, të cilat tejkalojnë ±2%, ndërsa AK / komisioni I vlerësimit nuk e ka analizuar dhe nuki ka konstatuar këto gabime.

AK në dosjen e tenderit ka hartuar tabelën e përshkrimit të çmimeve ka kërkuar për secilin pozicion që çmimet në ofertë të vendosen me DDP (që nënkupton më të gjitha taksat – përfshirë TVSH)nga e cila tabelë shihet se edhe totali I ofertës është dashur të rrjedh nga çmimet për pozicione së bashku me TVSH, ndërsa OE HAEM & ASTOR ka llogaritur normën e TVSH ekstra edhe tek tabela për mbledhëse nga kjo rrjedh se ky OE TVSH e ka kalkuluar dyfish në ofertën e tij, si dhe ky kalkulim ndryshon nga kalkulimi I bërë në ofertën e dorëzuarnga ne, OE BallkanPetroll SHPK si dhe kalkulimi I ofertës nga OE ENBI POWER shpk, si

dhe në kundërshtim me kërkesën e vetë AK.

Mëposhtë e kemi paraqitur tabelen e përshkrimit të çmimit- Përmbledhjen e OE HAEM & ASTOR ku konstatohet se I njejti ka kalkuluar dy here TVSH-në:

Tabela "Schedule 1" ka vlerëntotale DDP 1,124,035.00€ (1,060,035.00€ + 64,000.00€)

Tabela "Schedule 2" ka vlerëntotale DDP 118,210.00€ (92,426.00€ + 25,784.00€)

Totali i dy tabelave DDP përfshirë TVSH është **1,242,245.00€** e jo siq e ka paraqitur OE HAEM & ASTOR **1,465,849.10€,** pra ndryshimi i çmimit tejkalon 2% e vlerës së lexuar në hapje të oferatave dhe është dashur të veprohet konform nenit Neni 59, paragrafi 3.

Shembull: Në tabelën më poshtë kemi paraqitur në formë tabelare kalkulimin e çmimeve, respektivisht se si ish dashur të llogaritej oferta financiare OE HAEM & ASTOR:

Projekti i Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës

Përmbledhja e madhe

Nr.	Përshkrimi	Çmimi në total DDP EURO	ndërtimi / ngritja / vënja në funksion EURO	TVSH 18%	Kostoja totale EURO	TVSH 18%	Kostoja totale EURO
		A	B	C=(A+B)x18%	D=A+B+C	C=B/18%	D=A+B
1.	Programi 1: Dizenjimi, furnizimi dhe instalimi i impiantit dhe pajisjeve përfshirë pjesët e detyrueshme të rezervës	1,060,035.00	64,000.00	202,326.30	1,326,361.30	171,462.96	1,124,035.00
2	Programi 2: Dizenjimi dhe Ndërtimi i Punëve Inxhinierike	92,426.00	25,784.00	21,277.80	139,487.80	[illegible]	[illegible]

Çmimi pa TVSH	1,242,245.00	Çmimi pa TVSH	[illegible]
TVSH	223,604.10	TVSH	[illegible]
Çmimi TVSH	1,465,849.10	Çmimi TVSH	1,242,245.00
Si ka vepruar OE HAEM &ASTOR		Si duhet dashur te veprohet	

Nga dëshmitë e lartë cekura mund të konludojmë se diferenca respektivisht gabimet aritmetikore në ofertën e OE HAEM & ASTOR janë në vlerë prej 223,604.10 € nga e cila vlerë konstatohet se ka gabime mbi normën ±2%, të vlerës totale të ofertës.

Eksperti shqyrtues sqarone se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listen e përshkrimit të çmimeve, normën e TVSH-së e ka aplikuar dy herë, nese TVSH-ja është më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës, nuk konsiderohet si gabime aritmetikore, sipas KRPP-së Ndimesë- pyetjete e shpeshta pika 46 thuhet:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime

shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.4

Pretendimi ankimor ka te bej me: Po ashtu tek oferta financiare OE HAEM & ASTOR, në tabelën e përshkrimit të çmimeve për pjesën 4 Spare Parts çartë shifet se OE HAEM & ASTOR ka ndërhyrë në tabelën e përshkrimit të çmimeve dhe ka shtuar pjesë të cilat ndryshojnë formën origjinale të tabelës së përshkrimit të çmimeve.

Eksperti shqyrtues sqarone se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në tabelën -Programi 1 të përshkrimi i çmimeve për pjesën 4 Spare Parts(Pjeset rezerve), ka berë ndërhyrje të përshkrimi tek pika 4 Pjeset rezerve, pika 4.1, 4.2, 4.3, 4.4,

Tabela -Programi 1 sipas dosjes se tenderit.

4.	Spare Parts		
4.1	110 kV transformer oil bushing	pcs	1
4.2	220 kV transformer oil bushing	pcs	1
4.3	10(24) kV transformer bushing	pcs	1
4.4	35 kV transformer bushing	pcs	1

Tabela- Programi 1 e pltsuar nga OE i rekomanduar për kontratë me nderhyrje .

4.	Spare Parts		
4.1	110 kV transformer oil bushing - code 550 800A TRENCH	pcs	1
4.2	220 kV transformer oil bushing - 1050 800A TRENCH	pcs	1
4.3	10(24) kV transformer bushing 20NF 630 Ankara Seramik	pcs	1
4.4	35 kV transformer bushing 30 NF 1000 Elmek	pcs	1

Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.5

Pretendimi ankimor ka të bej me: Gjithashtu OE HAEM & ASTOR me rastin e dorëzimit të ofertës ka ofruar specifikacion teknik i cili nuk është konform dosjes së tenderit respektivisht sqarimeve të bëra nga AK përmes pyetjeve dhe përgjigjjeve të dates 24.09.2020 ku AK ka bashkangjitur në platformen e E-prokurimit verzionin 2-Technikal data të azhuruar/përmisuar. Ndersa ky operator ekonomik ka nderyhyrë në specifikacioni technical data duke bartur shënime nga verzioni 2- sqarimi i tenderit dhe duke inkorporuar në verzionin 1.1 të dosjes së tenderit (i cili është korigjuar me sqarimet e paraqitura nga AK në platformën e E-prokurimit-verzioni 2 dt.24.09.2020), më konkretisht ky operator ekonomik ka dorëzuar së bashku me dosjen

e tenderit specifikacionin e verzionit 1.1 e jo verzionin 2 të korigjuar nga AK si dhe në verzionin 1.1 ka tentuar të inkorporoj specifikacionin sipas verzionit 2 mirëpo duke lën mangësi të shumta e në veqanti në pozicionin 25-te humbjet e trafos e ka lën përshkrimin e verzionit të vjetër(1.1) që ka qenë në maksimum 211, kurse në verzionin e ri (2) me sqarime ky pozicion është përshkruar vetëm 211-pa maksimum.(me përshkrimin 211 lejohet tolerancë + me standarde according to IEC standard, ndërsa me verzionin e vjetër maksimum 211 nuk lejohet tolerancë + me standarde according to IEC)

Eksperti shqyrtues sqarone se pas sqarimeve shtese përmes pytjeve/përgjegjie të datës 24.09.2020 autoriteti kontraktues ka ndryshuar specifikacioni nga "verzioni1.1" në "verzionin 2", ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofertuar sipas verzionit 1.1, andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.6

Pretendimi ankimor ka të bej me: Po ashtu grupii OE HAEM & ASTOR nuk ka dëshmuar se ka referenca se ka energjizuar transformator 110kV dhe 220kV dhe nuk ka dëshmuar se ka ndërtuar themele/bazamente të transformatorëve 110 kV dhe 220 kV në tri vitet e fundit, por ka dorëzuar referenca për liferimin e transformatorëve dhe me këtë nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Në përgjigje të pyetjes sqaruese "add informNo 5-part one" ne fq. 54/70 është sqaruar se O.E. duhet të këtë bërë ndërtimin e bazamentit/themelit, instalimin dhe energjizimin e së paku një transformatori të nivelit 110 kV dhe një transformatori të nivelit 220 kV në tre vitet e fundit.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofruar "List of delivered Transformers si dhe referenca për transformatoret të natyrës se ngjajshme, mirëpo autrotiet kontraktues mund të kerkoje sqarime lidhur me referenca e ofruar për transformatore.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.7

Pretendimiankimor ka tëbej me:- Nga ndarja e punëvedhepërgjegjësivenëmarrëveshjen e konzorciumitshihet: ASTOR TRANSFORMATOR dizajnon dhe prodhon transformatorët, ndërsa HAEM ENERJI – BRANCH IN KOSOVA koordinon punët e ndërtimtarisë dhe paguan taksat.

ASTOR TRANSFORMATOR shall do the design and manufacturing of the power transformers, whereas HAEM ENERJI – BRANCH IN KOSOVA shall coordinate civil works and pay import duties and local taxes and hereby do the invoicing to the Contracting Authority.

Konstatim:

Refrencat e dorëzuara nuk janë complete pasi që prodhuesi ASTOR TRANSFORMATOR ka prodhuar dhe liferuar transformatorë, ndërsa nuk ka dorëzuar referenca për punët si ndërtimin e bazamentit/themelit, instalimin dhe energjizimin e transformatorëve.

Eksperti shqyrtues sqarone sipas RrOUPP - 27. Grup i Operatorëve Ekonomik, 27.3 Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.Prandja, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofruar marrveshjen e konzerciumit mes antarëve të gruopit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik nakues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1.8

Pretendimi ankimor ka të bej me: - Vlerësojmë se project menaxheri Z. Eldar Mammadov nuk e plotëson kriterin e kërkuar, citoj: "**Menaxheri I Projektit duhet te kete se paku 5 vite pervoje pune te natyrës se ngjashme, dhe njohje te rrjedhshme të gjuhës Angleze. Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesës**".

Nga diploma e Z. Eldar Mammadov shihet se ka diplomuar në Bachelor në shkencat e inxhinjeri së Mekanike me dt. 13.06.2015. Nga data e diplomimit 13.06.2015 derite data e hapjes se ofertave 06.10.2020 janë 5 vite 3 muajdhe 23 ditë, periudhë e cila mund të merret si pervojë e punes.

Në dokumentet e pranuara nga ju askund nuk kemi parë se keni verifikuar vërtetësinë e deklaratës rreth Projekt Menaxherit se ka sëpaku 5 vite përvojë pune të natyrës së ngjashme.

Nëtëgjithashtetetdihet se pas diplomimitrespektivishtpunesimitsëpaku 6 deri 12 muajduhettëketëpunëpraktike, pastajteemërohetnëpozitaadekuatedhetëmveshet me përgjegjegjësi.

Menaxhimi i projekteve të punëve me natyrë të ngjajshme kërkon jo vetëm shkollim por edhe pervojë të gjatë, të cilën PM nuk e posedon.

Vlerësojmë se deklaratapërpërvojën e menaxherittëprojektitnukështë e vërtetëdhejuvesi A.K. ju ka futnëlajthitje, nëkëtërast O.E. ka shkelurDeklaratennënbetim.

Kërkojme që ky fakt të verifikohet gjatë procesit të Ri-vleresimit.

Ekspertishqyrtuessqarone se është kopetencë e autoritetikontraktuestëverifkojëprojektmenaxheriz.E.M. Diploma e Z. Eldar Mammadov, ka diplomuarnë Bachelor nëshkencat e inxhinjerisëMekanike me dt. 13.06.2015. Nga data e diplomimit 13.06.2015 derite data e hapjes se ofertave 06.10.2020 janë 5 vite 3 muajdhe 23 ditë, periudhë e cilamundtëmerretsipervojë e punes.

PërgjigjenëPretendimi nr.1.9

Afativaliditetittëofertësnukështëkorrekt, është kërkuar "Periudha e vlefshmërisësëtenderit**90** ditë", në formular tëtenderit ka deklaruar: "Ky tender është valid përnjëperiudhëprej**15.01.2021** osemuaj: oseditë: nga data finale përdorëzimtëtenderëve.", kjofjalimundtëinterpretohet por nëthelbnuk ka kuptim.

Ne nenin 7, Pjesa I. Formulari i Tenderit është e cekut "Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK".

Eksperti shqyrtues sqarone se periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë, ose ___muaj, ose deri në datën____.Ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar periudhen e vlefshmërisë e ka ofruar , 4. Ky tender është valid për një periudhë prej 15.01.2021 ose muaj: ose dite: nga data finale për dorëzim të tenderëve.Prandaj, periudha e vlefshmërisë së tenderit e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është konform dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimi *2- Te Operatori Ekonomik EMTA ENERJI ELEK.INS. VE MUH.TICA.S*

- Nga qasja në dokumente kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave conform nenit 7 dhe 59 të LPPsë duke mos I trajtuar ofertat në mënyrë të barabartë sepse neve na kanë eliminuar me arsytimin se nuk e kemi plotësuar çmimin tek pozicioni 1 itabelës për punët inxhinierike ndersa tek OE EMTA nuk është lëshuar në vlerësimin të detajuar.

Këtë e themi për arsye se OE EMTA përveq se nuk e ka plotësuar pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshktimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar ne, gjithashtuky operator ka shumë defekte tjera si në tejkalim të buxhetit, gabim në përllogaritjen e çmimeve, në referenca, etj, për Autoritetin Kontraktues është cilësuar se nuk është ipërgjegjshëm vetëm për tejkalim të buxhetit pa u lëshuar në vlerësim më të detajuar.

Si fakt paraqesim tebelen e plotësuar nga OE EMTA ku shihet se edhe ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar të njëjtin pozicion sikurse edhe ne:

Eksperti shqyrtues sqarone se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik EMTA për të njejtin pozicion nuk ka ofruar çmim, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE EMTA duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuksseshme.

Tabela: Programi 2 pozicioni 1 nuk është plostuar nga OE EMTA.

Schedule 2: Design and Construction of Civil Works

	Description	Unit	Quantity	Unit price DDP EURO	Total price DDP EURO	Works EURO	Total costs EURO
1.	Soil investigation and site preparation		lump-sum				
2.	Fushe Kosova 110/35/10(20) kV Substation						

Andaj, pertendimi ankimore I opertaorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi 3- ***Te operatori Ekonomik ENBI POWER SHPK***

Edhe te ky Operator Ekonomik, Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit në raportin e vlerësimit dhe letrën standarde e ka cilësuar se është i përgjegjshëm administrativisht, vetëm kinse I njëjti e ka tejkaluar buxhetit pa u lëshuar në vlerësimin e detajuar.

Edhe ky OE nuk ka plotësuar pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshkrimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar edhe ne.

Gjith ashtu ky operator nuk I plotëson edhe referencat e kërkuara dhe ka vërej tjetjera në ofertën e tij.

Si fakt paraqesim tebelën e plotësuar nga ENBI POWER SHPK ku shihet se edhe ky OE nuk e ka plotësuar të njëjtin pozicion sikurse edhe ne.

Eksperti shqyrtues sqarone se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik ***ENBI POWER SHPK*** për të njejtin pozicion nuk ka ofruar çmim, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE ***ENBI POWER SHPK*** duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuksseshme.

Schedule 2: Design and Construction of Civil Works

	Description	Unit	Quantity	Unit price DDP EURO	Total price DDP EURO	Works EURO	Total costs EURO
1.	Soil investigation and site preparation		lump-sum				
2.	Fushe Kosova 110/35/10(20) kV Substation						

Përgjigje në Pretendimi **4-** Te Operatori Ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK

Edhe për këtë OE, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur të përgjegjshëm dhe vetëm ka thënë se çmimi i tij ka qenë më i lartë. Autoriteti Kontraktues / komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin detaj të këtij operatori ku i njejti ka shumë defekte në ofertën e tij e për çudi AK edhe këtë operator e shpall të përgjegjshëm administrativisht.

Edhe ky OE nuk e ka plotësuar në tërësi pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshkrimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar ne dhe i cili pozicion në tabelë ka qenë obligativ të plotësohet dhe OE ka qenë i obliguar që çdo pozicion në tabelë ta plotësoj konform kërkesës së AK dhe nenit 39.8 të RRUOPP(shif tabelën e mëposhtme) .

Tabela: Programi 2-pozicioni 1 - **EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK**

Programi 2: Dizainimi dhe Ndërtimi i Punëve inxhinierike							
	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi DDP EURO	Çmimi në total DDP EURO	Punët EURO	Kostoja totale EURO
1.	Analiza e shpimeve te tokës dhe përgatitja e terrenit		paushall			10,000.00	10,000.00
2.	[illegible]						
	Te gjitha themelet do te kompletohen ne çdo aspekt dhe duhet te jene si betonit te armuar duke përfshire betonin e lëgët sipas kërkesave tëkëlke, heshtimin e tokës, shtresën përfundimtare dhe rimbushjen e tokës						
2.1	Për transformatorin e ri te energjisë 110/35/10 (20) kV, 40 MvA dhe te ardhmen 110/20 (20) kV, 40MVA	copë	2	18,000.00	36,000.00	2,000.00	38,000.00
2.2	Ndërtimi i sistemit të ri ndërrese [illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]

Eksperti shqyrtues sqarone se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik ***EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK*** për të njejtin pozicion nuk ka plotsuar çmim" **çmimin në total DDP EURO"** është kopetence e autoriteti të sqarojë rreth përshkrimit të çimeve, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE ***EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK*** duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuskseshme. Andaj, pretendimi ankimor I operatori ekonomik ankues është i bazuar.

Shembull: Në tabelën më poshtë kemi paraqitur në formë tabelare kalkulimin e çmimeve, respektivisht se si ish dashur të llogaritej oferta financiare OE EL POWER & AL FOCUS 7:

Projekti i Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës

Përmbledhja e madhe

Nr.	Përshkrimi	Çmimi në total DDP EURO	ndërtimi / ngritja / vënja në funksion EURO	TVSH 18%	Kostoja totale EURO	TVSH 18%	Kostoja totale EURO
		A	B	C=(A+B)x18%	D=A+B	C=D/118%	D=A+B
1.	Programi 1: Dizenjimi, furnizimi dhe instalimi i impiantit dhe pajisjeve përfshirë pjesët e detyrueshme të rezervës	1,265,200.00	51,700.00	237,042.00	1,316,900.00	[illegible]	[illegible]
2	Programi 2: Dizenjimi dhe Ndërtimi i Punëve Inxhinierike	102,000.00	9,200.00	21,816.00	121,200.00	18,982.71	121,200.00
				Çmimi pa TVSH	1,438,100.00	Çmimi pa TVSH	[illegible]
				TVSH	258,858.00	TVSH	217,845.76
				Çmimi TVSH	1,696,958.00	Çmimi TVSH	[illegible]
				Si ka vepruar OE EL POWER		[illegible]	

Eksperti shqyrtues sqarone se operatori ekonomik EL POWER&AL FOCUS 7 në listen e përshkrimit të çmimeve, normën e TVSH-së e ka aplikuar dy herë, nese TVSH-ja është më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës, nuk konsiderohet si gabime aritmetikore, sipas KRPP-së Ndimesë- pyetjete e shpeshta pika 46 thuhet:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor ka të bej me: OE EL-POWER & AL FOCUS 7 ka deklaruar se posedon Menaxherin e projektit me pervojë pune mbi 5 vite, por **nuk ka deklaruar se ka pervojë të natyrës së ngjajshme**, si dhe nuk ka ofruar asnjë deshmi si diploma, kontrata e punës dhe referencat për menaxhimin e projekteve të realizuara. Në këtë rast pasi nuk e ka konkretizuar kush është Menaxheri I projektit deklarata është e thatë dhe pasubjekt.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 në oferten e tij ka ofruar deklarte për projek menaxher , por nuk ka ofruar ndonje CV apo Diplome për projekt menaxherin. Andaj, pretendimi ankimore I operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor ka të bej me: - Referencat e natyrës së ngjajshme jane per furnizim dhe montim te transformatoreve 110 kV, ndersa mungon referenca per energjizim te transformatoreve 220 kV si dhe nuk ka dëshmuar se ka ndërtuar themele/bazamente të transformatorëve 110 kV dhe 220 kV në tri vitet e fundit.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 ne oferten e tij ka ofrur Referenca e natyrës së ngjajshme për furnizim dhe montimin e transformatoreve 110kV, ndërsa për transformatoreve 220 kV, në oferten e tije ka ofruar vetëm kontratën por jo Referencat.

Po ashtu autoriteti kontraktues kërkese për rishqyrtimi të operatorit ekonomik ankues nuk e ka shqyrtuar as një pretendim ankimor. Autoriteti kontraktues ka vepuar në kundershtim me Neni 108/A pragrafi 12. Duke nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesë për rishqyrtimi pa analizuar as një pretendim ankimor të parashtruar nga operatori ekonimk ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lart përmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e bazuar, të anulohet njoftimi për dhenjë Kontratës dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlersim.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore lidhur me ankesat me numër te protokollit 1072-1080-1083-1089-1097.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 31.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "EL-Power & AL-Focus" LOT 4

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Grupi ynë i Operatoreve Ekonomik EL-POWER, AL FOCUS7 sh.p.k jemi njoftuar nga AK se oferta (tenderuesi) i pasuksesshëm për tenderin ne fjale, pa te drejte, ne mënyrë jo objektive dhe jo ligjore për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te drejte te gjendjes faktike si dhe shkeljes se dispozitave ligjore nga ana e AK Oper.Sistemi,Trans, Dime Trgu KOST SHA, kështu qe duke u bazuar ne këtë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin tone është plotësisht i padrejte, jo objektiv dhe i shoqëruar me shkelje, ligjore, ku janë shkelur ne tërësi dispozitat e Ligjit te Prokurimit (LPP-s)Nr.04/L-042 si dhe dispozitat e RRUOPP-secilat i precizojmë si me poshtë. eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Bazuar ne letrën standarde për njoftim te tenderuesit (B46), operatori ekonomik ankues është kualifikuar si tenderues i pa suksesshëm. Pra oferta e OE ankues nga komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues nuk është eliminuar siç thekson OE ankues. Nuk është rekomanduar për kontrate ne LOT 4 për shkak te çmimit me te lartë te ofertës ne raport me operatorin ekonomik fitues. Pra nuk qëndron pretendimi se oferta e OE është eliminuar, oferta ka qene e pasuksesshme.

Ne ankesën e OE ankues e cila është e ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi nuk është theksuar asnjë pretendim tjetër dhe nuk është përmendur asnjë nen apo dispozite e LPP-se e cila është shkelur nga AK. Pra ankesën te cilën e ka shkarkuar eksperti shqyrtues nga sistemi elektronik është e mangët dhe pa asnjë dëshmi apo pretendim për shkelje te LPP-se. Prandaj nuk kemi se çka te shqyrtojmë ne këtë ankese.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Electra" LOT 3

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate për LOT 3 ka dorëzuar ofertën me dy variante të variante të njëjta të zgjidhjes teknike nga dy prodhues të ndryshëm për mbrojtje Rele dhe SCADA nga prodhuesi SIEMENS dhe GENERAL ELECTRIC. Ndërsa sipas FDT-së pika 4.1 variantet nuk kanë qenë të autorizuar, pra në këtë rast është bërë shkelje e nenit 29 të LPP-së (variantet e specifikimeve teknike), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Specifikimi teknik i kësaj lende është mjaft voluminoz me shume material dhe bukur shume kompleks. Bazuar ne specifikimin teknik te dhënë nga AK ne gjuhen angleze qe është version gjuhësor mbisundues ne këtë rast, te pika 4.5.2 Protection Equipment (faqe 123-124) shkruan:

"Main protection system devices must be from the same Manufacturer as the substation control system. Only second main protection and some less important devices (back-up protections and control panels, transformer monitoring units, AVC for OLTC, etc.) might be from a different Manufacturer". Sipas ketij formulimi në specifikimin teknik te dosjes se tenderit, pajisjet kryesor te sistemit mbrojtës duhet te janë nga i njëjti prodhues, si kontrolli i nënstacionit te sistemit, kurse mbrojtja e dyte kryesore dhe disa pajisje më pakë të rëndësishme (mbrojtja rezervë dhe panelet e kontrollit, njësitë e monitorimit të transformatorëve, AVC për OLTC, etj) munden të janë nga një prodhues tjetër..

Nga kjo rezulton se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur variante por ju ka përmbajtur specifikimit teknik të dhënë si më lartë që ka mundësuar prodhues të tjerë për pajisje jo shumë të rëndësishme. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Për pretendimi vijues per piken 2 dhe 3 ankesës së OE ankues, se Autoriteti Kontraktues KOSTT ne përgjigjet klasifikuese te dërguara me date 24.09.2020 nga ora 14:12 deri ne orën 14:52 dokumenti 4. Add information No 3- part two-20200924 . Operatori ekonomik Enbi Power ne dosjen e dorëzuar ne KOSTT dhe pyetjet qe janë bere nga komisioni për vlerësim Operatori Ekonomik Enbi Power është deklaruar se pranon qe mbrojtjet te jene nga prodhuesi Siemens dhe ne gjate kontrolles kemi pare qe Operatori Ekonomik Enbi Power ka deklaruar se për Mbrojtjet Rete "backup" te prodhuesi ABS ose Schneider Electric dhe për këto mbrojtje gjate kontrollës qe i kemi bere kemi ardhur ne përfundim qe mungon deklarata e nënshkruar nga Operatori Ekonomik si dhe Referencë Lista duke specifikuar te gjitha pajisjet ku janë liferuar për Mbrojtje Rele për Prodhuesit ABB. Po ashtu sipas pikës 3 te ankese mungon edhe Autorizimi nga prodhuesi, eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Ne ofertën e OE fitues për LOT 3 qe është e ngarkuar ne platformën e prokurimit e-prokurimi janë te bashkangjitur deklarata e nënshkruar nga OE i rekomanduar per kontrate dhe reference lista qe specifikon pajisjet ku janë liferuar.

Kopjen e deklaratës po e japim me poshtë te kopjuar me "Take a snapshot" po ashtu me te njëjtën mënyrë te bashkangjitur ju japim edhe një faqe te listës se referencave si dëshmi. Përndryshe Lista e referencave ne

ofertën e OE te rekomanduar për kontrate përmbajnë disa faqe. Gjithashtu ne oferte është i bashkangjitur edhe autorizimi.

Mbi këtë baze vlerësojmë se pretendimi ankimor i OE ankues për këto dy pika është i pa bazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "DOKO" LOT 3.

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "DOKO" se AK ka bere shkelje neneve te LPP-se te përmendura ne ankese sepse ka eliminuar pa te drejte ofertën tonë për një kërkesë ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit qe nuk ka qene e specifikuar ligjërisht ne mënyrë specifike dhe adekuate as ne pjesën e specifikimit teknik ne gjuhen angleze dhe as ne pjesën e specifikimit teknik ne gjuhen shqipe për Terminalet e Kabullit te tensionit te mesëm, Data sheet (Fleta e te dhënave) për këtë kabull dhe as nuk ka kërkuar informacion shtese për këtë çështje, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas letrës standarde për eliminim qe AK i ka dërguar OE ankues, thuhet se "Data sheet" për kabull është pjesërisht e pa plotësuar (Mungon pjesa për MV Power Cable Terminations).

Pra ne ofertën e dorëzuar nga OE ankues nuk është e plotësuar ne tërësi Data Sheet Fleta e te dhënave për kabullin ne fjale. Ne raste si tani kur mungon specifikimi teknik për pajisje, apo nuk ofrohen komplet te dhënat ne ofertë nga tenderuesi për produktin përkatës, oferta vlerësohet si e papërgjegjshme.

Rregullat e Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik (RRUOPP) pika 39 (Sqarimi i Tenderëve) thuhet sipas tabelës ne vijim:

Problemi	**Si te veprohet**	**Neni i LPP-së**
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale te një produkti, ndërsa OE duhet te dorëzoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara.	**Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm**	**Neni 28 i LPP-se**

Mbi këtë baze autoriteti kontraktues ka vepruar drejtë sepse tabelat nuk kane qene te plota me te dhënat dhe parametrat adekuat te specifikimit teknik te kabullit ne fjale. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues "DOKO" se AK ka bere refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim duke mos ofruar asnjë përgjigje dhe argumente me arsyetim ligjor siç parashihet me nenin 108/A te LPP-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne vendimin e autoritetit kontraktues te datës 02.12.2003 qe ka nxjerre si përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim te OE ankues se Zyrtari përgjegjës i prokurimit refuzon kërkesën për rishqyrtim për arsye se asnjë nga konstatimet ne kërkesës nuk qëndrojnë.

Sipas pikës 8 dhe 9 te nenit 108/A autoriteti kontraktues është i obliguar qe te jep përgjigje me arsyetime detale për pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues ne baze te cilave dispozita kundërshtohen apo refuzohen pikat ankimor.

Ne rastin konkret autoriteti kontraktues nuk ka dhënë arsyetimet e nevojshme ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim te operatorit ekonomik ankues. Pra nuk janë zbatuar ne tërësi dispozitat e nenit 108/A te LPP-se.

Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor te bazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "G3 Inxhiniering" LOT 3.

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK ka rekomanduar per kontrate OE i cili është i papërgjegjshëm edhe per faktin se nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike përkatësisht tek Technical Data for 10(20) kV Medium Voltage .

Technical Data Schedule

2.1 Circuit Breaker.

2.1.17 Rated breaking current (asymmertrical) — ku është është kërkuar 40% d.c. comp — ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar 31%, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Oferta e OE te rekomanduar per kontrate për këtë pike lidhur me pozicionin 2.1.17 u shqyrtua edhe me larte ne përgjigje e pretendimeve te OE "Electra" i cili e kishte te njëjtin pretendim. Pra OE ekonomik i rekomanduar për kontrate ka ofruar 31% ndërsa është kërkuar ne specifikim teknik 40%. Ne këtë rast qëndron pretendimi ankimor. Shih me larte tabelen nr.2.1.17 te përgjigja ne pretendimin 3 te OE "Elecra". Eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin vijues te OE ankues se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek pozicioni 2.1.28 Maximum time interval between opening of interrupters of one phase — ku intervali i kërkuar është 3 ms, ndërsa OE i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me intervalin 63.

Pra ky fakt e tregon qarte papërgjegjshmërinë e OE te rekomanduar per kontrate, pasi qe nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike. Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm edhe për faktin se tek pozicioni 2.1.34 Mechanical life of circuit breaker and mechanism in, ku është kërkuar No. of operation - 100,000, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate e ka ofruar 30,000, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Nga oferta e OE te rekomanduar për kontrate këto te dhëna janë për vlerat e pretenduara për pozicionet e lartpërmendura te specifikimit teknik nga ana e OE ankues. Qëndrojnë te dhënat se OE i rekomanduar për kontrate për pozicionet ne fjale ka vlera te ndryshme nga ato te kërkuara ne DT. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin vijues te OE ankues se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm për shkak se vlerat e ofruara ne pozicionet e me poshtme janë te ndryshme nga ato te kërkuar ne DT.

Tek pozicioni 6.12 Voltage transformer

14. I secondary është kërkuar 30 VA, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA
15. II secondary është kërkuar 30 VA ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA.

Shihet qarte se edhe ne ketë pozicion OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofertuar ashtu siç është kërkuar dhe është dashur te shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-se, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ky pretendim është shqyrtuar me larte te përgjigja ne pretendimin 3 te "OE Electra" shih aty tabela 6.12 Pra si i tille pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin vijues te OE ankues se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm per shkak se vlerat e ofruara ne pozicionet e me poshtme janë te ndryshme nga ato te kërkuar ne DT.

Tek pozicioni 6.12 Voltage transformer

14. I secondary është kërkuar 30 VA, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA
15. II secondary është kërkuar 30 VA ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar 5-10 VA.

Shihet qarte se edhe ne ketë pozicion OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofertuar ashtu siç është kërkuar dhe është dashur te shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-se, eksperti shqyrtues ka kete mendim.
Ky pretendim është shqyrtuar me larte te pergjigja ne pretendimin 3 te "OE Electra" shih aty tabela 6.12
Pra si i tille pretendimi ankimor është i bazuar.

Ndërsa nuk qëndron pretendimi ankimor i OE ankues "G3 Inxhiniering" LOT 3 se Tabela 15 e çmimeve ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate ka 10 pozicione ndërsa janë plotësuar vetëm 9 pozicione. Nga tabela shihet se janë plotësuar gjithsej 10 pozicione. Shih tabelën me poshtë te OE fitues.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "KONCAR" për LOT 1

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se është shpallë pa përgjegjshëm për shkak te keq funksionit të Portalit KRPP, që qoi atë që të mos jetë në gjendje të ngarkonte një pjesë të dokumenteve të tenderit të cilat Autoriteti Kontraktues më vonë deklaroi se nuk ishin siguruar.

Afati i fundit për ngarkimin e tenderit ishte 06/10/2020 10:00

Gjatë ngarkimit të tenderit më 06/10/2020 në 04:00 OE ankues ka përjetuar mosfunksionim të portalit KRPP ku ne nuk ishim në gjendje të ngarkonim ofertën dhe të gjitha bashkëngjitjet përkatëse. Ne kemi njoftuar agjencinë KRPP dhe AK me kërkesën për zgjatjen e afatit por asnjë përgjigje nuk është dhënë që nga ajo kohë (ju lutemi gjeni ankesat me e-mail në nenin 9 - lista e provave), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE ankues nuk ka ngarkuar ne platformën e KRPP-se te gjitha dokumentet e nevojshme te ofertës te kërkuara sipas dosjes se tenderit. Ketë e arsyeton me faktin se nuk ka funksionuar sistemi elektronik i KRPP-se dhe ai nuk ka mundur ti ngarkoj te gjitha dokumentet e ofertës. Pra oferta e OE ankues është dorëzuar jo e plote ne sistemin elektronik, mungojnë një numër i konsiderueshëm i dokumenteve te kërkuara sipas dosjes se tenderit ne mënyrë qe një OE te shpallet i përgjegjshëm. Pamundësia e ngarkimit te ofertës se plote ne sistemin e e-prokurimit nga OE ankues për shkak te pengesave te mundshëm ne sistem, nuk është arsyetim për autoritetin kontraktues dhe as përgjegjësi e tije.

Meqenëse te gjithë ofertuesit e tjerë pjesëmarrës ne ketë aktivitet te prokurimit kane arritur ti dorëzojnë këto dokumente, dëshmon se sistemi ka qene ne rregulle, nuk ka pasur ndonjë problem teknik se atëherë edhe ofertuesit e tjerë do ta kishin te njëjtin problem.

Ne ofertën e OE ankues mungojnë dokumentet e tenderit si Deklarata nene Betim, dëshmitë e qarkullimit financiar, katalogët, Deklarata për specifikim teknik, garancionet e punimeve, menaxherin e projektit dhe te

vend punishtes pajisjet dhe makineritë. Ne disa pozicione për LOT 1, nuk ka çmim fare si pozicioni 14.1 i tabelës se pare dhe pozicioni 1.5 i tabelës se dyte ka çmim me vlere 00 i cili nuk lejohet sipas LPP-se.

Mungesa e këtyre dokumenteve është ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se dhe e bene ofertën e pa përgjegjshme. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues se Dëshmitë mbi kërkesat e aftësive teknike dhe / ose profesionale paraqitur nga OE. ABB Power Grids Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale sipas kërkesave te tenderit. Kërkesa për LOT 1 & 2 - Ofertuesi duhet të provojë se ka zbatuar të paktën tre projekte të nënstacioneve GIS, të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm 110kV ose më të lartë, brenda 3 viteve të fundit, në vendet e BE-së duke përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne dokumentet e ofertës te dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate për LOT 1, ABB PowerGrids Zagreb d.o.o. ka ofruar 8 referenca të natyrës së ngjashëm sipas kërkesave ne dosjen e tenderit. Lista e referencave është e bashkangjitur ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate dhe është lehte e çaseshme. Eksperti shqyrtues vlerëson se referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontrate për projektet e kryera i plotësojnë kërkesat e dosjes se tenderit për aftësive teknike dhe/ose profesionale dhe janë ne përputhje me nenin 69 te LPP-se. Si të tilla këto referenca janë te pranueshme. Prandaj eksperti shqyrtues e vlerëson si pretendim ankimor te pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin vijues te OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate ABB Power Grid nuk plotëson kërkesat minimale teknike - fleta e të dhënave pjesërisht jo e plotë (mungon faqja 8 - 20 nga 21). Dokumentet teknike që vërtetojnë pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat teknike të vendosura nga OE në lidhje me fletën e të dhënave teknike të plotësuara për pajisjet elektrike 35kV MV që u janë dërguar tenderuesve në sqarimet 02_shtoni informacionin nr. 3 - pjesa e dytë-20200924, DT-MP-004, Info 6 Pyetja Nr. 11, faqe 8 deri në faqen 20 nga 21 mungon dhe do të bëjë EO ABB Power Grids Zagreb mos plotësoni kërkesat minimale dhe duhet të eliminohen, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Dokumenti "Sqarimet 02_shtoni informacionin Nr.3- pjesa e dytë – 20200924. DT-MP-004, Info 5 Pyetja Nr.11 në të cilën ankuesi i referohet nuk është dokument që ka të bëjë me "LOT 1 - Ndërtimi i SS 110/10(20)kV Ferizaj3".

Ky dokument (fletët e të dhënave teknike për 35kV pajisje elektrike) është relevante vetëm për "LOT 3- Ndërtimi i tenderit të ri SS 220/35/10(20) Malisheva & OHL" Kjo mund të shihet nga titulli i dokumentit të

fletës së të dhënave teknike dhe nga pyetja e njëjtë nr. 11 ku thuhet "LOT 3 - Mungojnë fletët e të dhënave dhe metalet e izoluara 35 kV"

Ndërsa sa i përket pikës tjetër, Kompania DOKO sh.p.k. nuk ka dorëzuar tender për LOT 1 – Ndërtimi i SS 110/10(20)kV Ferizaj 3 dhe ata nuk kanë ndonjë pasojë ligjore mbi këtë pretendim as nuk është situatë e ngjashme siç deklaroi OE ankues. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.4

Pretendimi vijues i OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate ABB Power Grids nuk plotësojnë kërkesat minimale teknike - fletë e të dhënave pjesërisht jo të plota (Faqe 1 deri në faqen 4 nga 7).

Dokumentet teknike që vërtetojnë pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat teknike të vendosura nga CO në lidhje me fletën e të dhënave teknike të plotësuara për Transformatorët e Energjisë që u është dërguar tenderuesve në sqarimet 07_ shtoni informacionin Nr. 5-partone, DT-MP-004, Tabela 1:

Të dhënat teknike për Transformatorin e Energjisë 110/35/10 (20) kV, faqe 1 deri në faqen 4 nga 7 mungojnë dhe Rrjetet e Energjisë EO ABB Zagreb d.o.o. nuk plotësojnë kërkesat minimale dhe duhet të eliminohen. Shkelja e ngjashme, fletë e të dhënave pjesërisht e paplotë, në ofertën e "DOKO" sh.p.k paraqitur për LOT 3 të tenderit subjekt rezultoi në eliminimin e tenderuesit bazuar në B42 - Letra standarde e marrë për tenderuesin e eliminuar të marrë më 24.11.2020, eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Dokumenti "Sqarimet 07_shto informata Nr. 5 – pjesa e parë, DT-MP-004, tabela 1, të dhënat teknike për transformimin e energjisë 110/35/10(20)kV në të cilën ankuesi referohet nuk është dokument i lidhur me "LOT 1- ndërtimi i SS 110/10(20)kV Ferizaj 3". Ky dokument "Të dhënat teknike për transformatorët e energjisë në 40MVA në SS 110/35/10(20kKV Fushë Kosovë dhe SS 220/35/10(20)kV Malisheva" vlen vetëm për "LOT 4 Furnizimi dhe instalimi i 40MVA transformatorët e energjisë në SS 110/35/10(20) Fushë Kosovë dhe SS/35/10(20)kV Malishevë prokurimi. Kjo mund të shihet nga kreu i dokumentit.

Kompania DOKO sh.p.k. nuk ka dorëzuar tenderin për LOT 1 – Ndërtimi i SS 110/10(20)kV Ferizaj 3 dhe ata nuk kanë ndonjë pasojë ligjore mbi këtë pretendim. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.5

Lidhur me pretendimin e OE ankues se provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga ABB Power Grids nuk janë të qarta - OE ABB Power Grids Zagreb d.o.o. nuk deklaroi nëse fusha e tij e furnizimit përfshin artikujt e përmendur më poshtë si të detyrueshëm, siç kërkohet nga kërkesa e tenderit.

Gjegjësisht, në lidhje me dokumentet teknike që vërtetojnë përmbushjen e të gjitha kërkesave të vendosura nga CO në lidhje me tërësinë e fushës së furnizimit me sistemin GIS bazuar në specifikimin teknik 20200817_Specifikimi Teknik SS Kastrioti, Artikuj 4.2 110 kV Pajisjet elektrike të izoluara me gaz 4.2.13

pajisjet dhe mjetet speciale që përcaktojnë: Pajisjet e mëposhtme do të sigurohen si pjesë e pajisjeve speciale dhe çmimet e tyre do të përfshihen në çmimin e tenderit dhe do t'i dorëzohen punëdhënësit në gjendje të mirë pas përfundimit të testit të komisionimit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE ekonomik ankues si duket nuk ka marre parasysh versionin e fundit te dokumenteve te lëshuara nga AK përmes informatave shtese nr.5.5 date 24.09.2020 duke u përgjigjur ne pyetjet 27 dhe 29 qe eshte përcaktuar si me poshtë.

Q: "20200817 – Specifikimet teknike

SS Kastrioti & 20200817 – Specifikimet teknike_ SS Fushe_AI_2; 4.2.13.

Në specifikimet teknike për LOT 1 dhe LOT 2 4.2.13 kërkohet nga Kontraktuesi të furnizojë pajisje dhe mjete speciale për trajtimin e gazit GIS, matjet elektrike, etj. Meqenëse kjo pajisje është e veçantë dhe ka gamë dhe larmi të madhe produkti, ju lutemi siguroni kërkesa të hollësishme teknike për mjetet e kërkuara.

A: "Pajisjet e tilla do të largohen dhe do të konsiderohen si jo pjesë e kontratës".

Bazuar në përgjigjen e cituar të Informacionit Shtesë është e qartë se pajisjet e tilla nuk ishin të nevojshme të siguroheshin për këtë kontratë, prandaj Oferta e ABB Power Grids Zagreb d.o.o është në përputhje me të gjitha kërkesat e tenderit. Mbi kete baze ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.6

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar per kontrate ABB Power Grids ishte i detyruar të nënshkruaj formularin e dorëzimit të tenderit me nënshkrim elektronik pasi ABB Power Grids posedon një nënshkrim të tillë elektronik, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas nenit 33 të Rregullave të udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik e lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, nënshkrimi i avancuar dixhital dhe vulosja në kohë e ofertës nga serveri nuk është e detyrueshme deri në njoftimin zyrtar nga KRPP-ja.

Pasi që KRPP nuk njoftoi zyrtarisht se përdorimi i nënshkrimit dixhital të përparuar dhe vulosja e kohës është i detyrueshëm. Prandaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.7

Lidhur me pretendim e OE ankues se provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE. ABB Power Grids d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente kush është prodhuesi pasi MAF ka çështjet vijuese, eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Ky pretendim bie në kundërshtim me tekstin e MAF të kontestuar nga Ankuesi. Pasi që nga kompania ABB Power Grids Sëitzerland Ltd me objekt prodhimi të produkteve të Tensionit të Lartë, GIS i regjistruar në Brown Boveri Strasse 5, 8050 Cyrih është prodhuesi i GIS Switchgear e cila është objekt i kësaj procedure të prokurimit publik, ajo kompani specifike ka lëshuar Formularin e Autorizimit të Prodhuesit dhe e nënshkruan atë në atë cilësi.

Në pretendimin e ankuesit thuhet se prodhuesi i kësaj pajisje specifike është një entitet juridik Hitachi ABB Power Grids. Ky interpretim është i pabazuar pasi që Hitachi ABB Power Grids në kontekstin e përcaktuar në MAF përfaqëson emrin e përbashkët të Hitachi ABB Power Grids pjesë e së cilës është ABB Power Grids Switzerland Ltd, në mesin e të tjerave, dhe jo entitet legal sikurse që është thënë nga Ankuesi. Për më tepër, nga detajet e vulës është qartë e qartë se cili është emri ligjor dhe adresa e prodhuesit që lëshoi MAF-in në fjalë.

Për më shumë, Hitachi ABB Power Grids zyrtar faqet e internetit të disponueshme për publikun tregojnë listën e kompanive që janë pjesë e brendit Hitachi ABB Poëer Grids në mesin e së cilave është edhe ABB Power Grids Switzerland Ltd. https://www.hitachiabb-poëergrids.com/africa/en/privacy-policy/subsidiaries

Vegza më poshtë tregon në faqen e fundit lista e të gjithë prodhuesve të GIS Switchgear në Hitachi ABB Power Grids Group.

https://search.abb.com/library/Doënload.aspx?DocumentID=1HC0108518&LanguageCode=en&DocumentPartId=&Action=Launch

Përgjigje në Pretendimin nr.8

Lidhur me pretendimin tjeter te OE ankues se, provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE. ABB Power Grids d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente se kush është saktësisht prodhuesi i pajisjes, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Deklarata nënshkruhet dhe vuloset nga Prodhuesi GIS – Kompania ABB Power Gridsb Zvicër Ltd, Impianti i prodhimit të produkteve të tensionit të lartë, Ndërprerësit e izoluar me gaz me selinë e saj të regjistruar në Brown Boveri Strasse 5, Cyrih, Zvicër. Arsyet e e theksuara ne edhe ne përgjigjen e pretendimit 7 e bëjnë këtë pretendim ankimor te pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.9

Lidhur me pretendimin tjeter te OE ankues se provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE ABB Power Grids Zagreb d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale pasi nuk është plotësisht e qartë dhe jo transparente kush saktësisht është prodhuesi i pajisjes lëndore, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lidhur me këtë pretendim ankimor i dhamë përgjigjet me larte ne pretendimin nr. 7.
Deklarata nënshkruhet dhe vuloset nga Prodhuesi GIS – Kompania ABB Power Gridsb Zvicër Ltd, Impianti i prodhimit të produkteve të tensionit të lartë, Ndërprerësit e izoluar me gaz me selinë e saj të regjistruar në Brown Boveri Strasse 5, Cyrih, Zvicër. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.
Përgjigje në Pretendimin nr.10
Lidhur me pretendimin e fundit te OE ankuese se provat mbi kërkesat e aftësisë teknike dhe / ose profesionale të paraqitura nga OE. ABB Power Grids d.o.o. nuk përmbushin kërkesat minimale nuk ka asnjë deklaratë të pakushtëzuar nga banka që thotë se E.O nuk ka qasje në burimin e financimit ekuivalent me vlerën e projektit, siç kërkohet nga Dokumenti i Tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Në përputhje me kërkesat nga Dokumenti i Tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (TDS), Kërkesave të Gjendjes Ekonomike dhe Financiare, pikat 8.1 & 8.2, E.O. ABB Power Grids Zagreb d.o.o. ka dorëzuar Letrën e Rekomandimit të lëshuar nga banka Zagrebacka banka d.d. duke deklaruar gatishmërinë e bankës të mbështetësi E.O. ABB Power Grids Zagreb d.o.o. në këtë projekt, duke vazhduar kreditë dhe duke lëshuar letër garanci dhe letra krediti.
Një Letër e tillë e Rekomandimit dëshmon se Tenderuesi ka qasje në burimet e financimit për vlerën e projektit, siç kërkohet nga Dokumenti i Tenderit.
Është pretendim i pasaktë se E.O. BB Power Grids Zagreb d.o.o. duhet të kishte dorëzuar Deklaratën e pakushtëzuar, pasi që kjo nuk ishte kërkuar në mënyrë eksplicite nga dokumenti i sipërpërmendur i tenderit.
Për më shumë, te neni 68 i LPP-se, Gjendja Ekonomike dhe Financiare, paragrafi 1, thuhet: Një autoritet kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi duke demonstruar se ato plotësojnë kërkesat minimale ekonomike dhe financiare, të specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin e kontratës. Si rregull i përgjithshëm, operatorët ekonomikë do të lejohen të plotësojnë një kërkesë të tillë, duke dorëzuar, siç mund të jetë relevante dhe e përshtatshme, një ose më shumë nga referencat e mëposhtme:

1.1. Një ose më shumë deklarata të përshtatshme nga një ose më shumë banka.

1.2. Dëshmi e një police të rëndësishme të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar e sigurimeve;

1.3. Kopje të vërtetuara të një ose më shumë bilanceve ose ekstrakteve nga bilancet e vendit të themelimit;

1.4. Kopje të pasqyrave të të ardhurave dhe raporteve të menaxhimit, të certifikuara nga një firmë auditimi e licencuar me reputacion.

Është pretendim i pasaktë i OE ankues që OE. ANN Power Grids Zagreb, nuk ka përmbushur kërkesat minimale, pasi që kjo nuk ishte kërkuar në mënyrë eksplicite nga AK.

Në pajtim me nenin 56, paragrafin 3 të LPP tenderuesi në rast të procedurave të hapura nuk do të skualifikohet, përjashtohet apo eliminohet nga procedura të tilla mbi bazën e ndonjë kërkese ose kriteri jo të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Për këtë aktivitet te prokurimit ne kemi pranuar 5 ankesa, te cilat i kemi shqyrtuar veç e veç. Për Lot 4 kemi pranuar dhe shqyrtuar një ankese te OE " EL-Power & AL-Focus7" e cila ka qene ankesë e mangët me dokumentacionin e ngarkuar ne E-prokurim dhe pa pretendime ankimore.
Për Lot 3 kemi pranuar dhe shqyrtuar 3 ankesa nga operatoret ekonomik "Electra", "Doko" dhe "G3 Inxhinering". Ndërsa për Lot 1 kemi pranuar vetëm një ankese nga OE "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport"

Meqenëse për Lot 4 nuk kemi një ankese pa pretendime ankimore sepse ankesa ka qene jo e plote e ngarkuar ne sistemin e-prokurimi, atëherë eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE "EL-Power & AL-Focus7" te refuzohet si e pa bazuar.
Për Ankesat e Operatorëve ekonomik ankues për Lot 3 "Electra", "Doko" dhe "G3 Inxhinering" eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe të aprovohen pjesërisht.
Mirëpo aktiviteti i prokurimit për këtë Lot 3 te anulohet sepse ka pasur probleme ne mes specifikimin teknik te dosjes se tenderit dhe standardeve te aplikueshme. Ne këtë mënyrë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës ne Lot 3, me ofertat e tyre ne disa raste ju kane referuar specifikimit teknik te dosjes se tenderit e ne raste te tjera standardeve te aplikueshme. Kjo ka rezultuar qe oferta e ofruara nga OE ankues ne Lot 3, mos ta plotësojnë ne tërësi parametrat e ofruara ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit dhe si te tilla kane rezultuar si ofertues te pa përgjegjshëm. Vlerësimi i ofertave ne këtë Lot nuk ka qene ne përputhje me nenin 59 te LPP-se.

Ankesa e OE ankues "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport" për Lot 1. ka qene totalisht e pa përgatitur dhe e pa përgjegjshme sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit për pika përmbajtjesore te saje. Po ashtu ka pasur pozicione te pa plotësuar ne listën e çmimeve. Vlen te theksohet se ne Lot 1 oferta e OE te rekomanduar për kontrate ke çmim me te ulet se oferta e OE ankues. Nuk ka shkelje nper Lot 1 te cilat do ta dëmtoni procesin e prokurimit.
Prandaj për ankesën ne Lot 1. te OE "Konçar Inženjering za energjetiku i Transport" eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ta refuzoj si te pa bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP" me nr. prok. KOSTT-20-4505-5-1-1

të - Për Lot 1 dhe Lot 4 te vazhdoj me dhënien e kontratës
- Për Lot 3 te anuloj njoftimin e vendimit për shpërblim me kontrate dhe nëse ka interesim me tutje ta Ritenderoj këtë Lot.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.12.2020 me raportin e ekspertizës, me numër 1053/20

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 31.12.2020 me raportin e ekspertizës, me numër 1072,1080,1083,1089,1097/2020.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 08.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu- KOSTT SII.A. Vendim i KOSTT sh.a. në Ekspertizën 1053/20 Operatori Ekonomik "BALLKAN PETROL" SHPK pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues KOSTT sh.a. për dhënie (B58) dhe brenda afatit të parashikuar me LPP, kanë parashtruar Ankesë pranë OSHP-së me nr. Protokolli 1053/20, me nr Protokolli 1053/20, për Aktivitetin e Prokurimit: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP" , për LOT 4 "Furnizimi dhe instalimi I transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova dhe NS 220/35 /10(20)kV Malisheva",
me nr. të prokurimit: Nr. i prokurimitKOSTT-20-4505-5-1-1 Nr. i brendshëm KOSTT 023/140/155/156/157/140/1-20-49-511. Në bazë të Nenit 115 të Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë, paragrafit 1, pas pranimit të ekspertizës nga eksperti shqyrtues me datë 06.01.2021, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit deklaron se: Vendimi i AK-KOSTT sh.a. AK-KOSTT sh.a. nuk pajtohet me propozimin e ekspertit që AK të kthej lenden ne Ri vlerësim. Arsyet janë si në vijim: Në lidhje me pretendimet e OE Ballkan Petrol sh.p.k për mos vendosje të çmimeve tek pjesa elektrike kolona "Construction/Erection, Commissioning" poz 1.2; 2.2; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 4.1; 4.2; 4.3; 4.4 sqarojmë që nuk kanë të bëjnë asgjë me ndërtim/konstruktim, ngritje dhe komisionim dhe se janë materiale te cilat thjeshte do te furnizohen apo shërbime që duhet të kryhen. Për të qenë sa më të qartë me poshtë po ju shënojmë këto pozicione ne Gjuhen Angleze dhe Shqipe: Poz 1.2 - NoteBook PC for maintenance/ Laptop për shërbime te mirëmbajtjes, Poz 2.2

- NoteBook PC for Project Supervision/ Laptop për Mbikëqyrje të Projektit, Poz 3.1 - Vehicle Drive Car as per specification/ Veture, sipas specifikimit,

Poz 3.2 - Training/Trajnim, Poz 3.3 - Inspection Tests/ Teste Inspektuese, Poz 3.4 - As Build Drawings/ Vizatime te Projektit Poz 4.1 - llOkV transformer oil bushing/ HOkV izolatorë me vaj për transformator Poz 4.2 - 220kV transformer oil bushing/ 220kV izolatorë me vaj për transformator Poz 4.3 - 10(24)kV transformer bushing/ 10(24)kV izolatorë transformatori

Poz 4.4 - 35kV transformer bushing/ 35kV izolatorë transformatori

OE ne fund te tabelave te ofertimit e ka treguar qartë se TVSH nuk është e përfshire çmimeve DDP por është e përfshirë ne tabelën e çmimeve Grupi i Operatorëve Ekonomik HAEM ENER.ELEK. & ASTOR TRANSFORMATOR tek pozicionet për pjesët rezervë vetëm ka ofruar si shtesë tipet e ofruara te pjesëve përkatëse rezervë . Sa i përket vlerave teknike në tabela AK konsideron se janë ne harmoni me kërkesat minimale të kërkuara.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatoret ekonomik të dorëzojnë dëshmi për së paku një projekt të energjizuar të transformatorëve llOkV dhe një projekt te energjizuar te transformatorëve 220kV. OE HAEM & ASTOR ka dorëzuar dëshmi te mjaftueshme ne lidhje me llojin e produktit, vlerën e kontratës dhe datën e energjizimit. Grupi i Operatorëve Ekonomik HAEM ENER.ELEK. & ASTOR TRANSFORMATOR ka dorëzuar Certifikate të Marrjes në Dorëzim nga Operatori i Sistemit dhe Transmisionit Turk TEIAS ku duket qartë që dy transformatorë 400kV janë energjizuar/ komisionuar me datat 03.03.2020 dhe 23.03.2020. Tutje po ashtu paraqiten dy Letër Referenca te lëshuara nga GUNGOR ELEKTRIK te cilat ofrojnë dëshmi te mjaftueshme ne lidhje me këtë kërkesë. Dëshmitë mbi përvojën e OE HAEM & ASTOR dhe referencat janë te mjaftueshme, ashtu siç e cekem me larte ne piken 1.6

Sa i përket pretendimeve ne lidhje me kërkesat financiare dhe teknike, AK qëndron pran asaj se OE i përzgjedhur i plotëson kërkesat në fjalë, pasi që i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Me respekt.

Operatori Ekonomik: "Ballkan Petrol"SH.P.K-Prishtinë, me datë 12.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar,Me datën 08.01.2021 kemi pranuar një Vendim apo Shkresë nga AK KOSTT SH.A. lidhur me ekspertizën **1053/20** për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS,Transformatorëve Energjetik dhe LP"- LOT 4 Furnizimi dhe instalimi I transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110 35 10(20) kV Fushë Kosova dhe NS 220 35 10(20)kV Malisheva" me nr. prokurimi KOSTT-20-4505-5-1-1, nr. i brendshëm: KOSTT 023/140/155/156/157/140/1-20- 49-511. Lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e "Ballkan Petrol" SH.P.K. me datën 18.12.2020 kemi pranuar raportin e

ekspertit nr. 1053/20 të datës 18.12.2020 si dhe me datën 21.12.2020 kemi njoftuar OSHP-në se ne Pjesërisht Pajtohemi me mendimin e Ekspertit, për shkak se i njëjti disa nga pretendimet tona nuk i ka trajtuar në tërësi. Për kundër që bazuar në legjislacionin për prokurim publik, Operatorët Ekonomik dhe AK kanë afatin ligjor 4 ditë që të përgjigjen se pajtohen apo nuk pajtohen me mendimin e ekspertit, shkresa e pranuar nga ana e AK me datën 08.01.2021 në lidhje me mendimin e ekspertit nuk është e qartë dhe nuk po kuptohet se a ka marr vendim apo është përgjigjur në mendimin e ekspertit, po ashtu në të njëjtën shkresë AK ka potencuar se mendimin e ekspertit e ka pranuar me datën 06.01.2021, duke tentuar me qëllim që ta fitojnë të drejtën apo të krijojnë afatin ligjor që të përgjigjen në mendimin e ekspertit edhe pse zyrtarët e AK-së kanë qenë të përfshirë në e-mailin e dërguar nga OSHP me datën 18.12.2020 me të cilin na kanë njoftuar dhe dërguar raportin e ekspertit. Me anë të kësaj shkrese edhe njëherë e njoftojmë Panelin Shqyrtues të OSHP-së se OE "Ballkan Petrol" Sh.p.k, lidhur me mendimin e ekspertit të dhënë me raportin nr. 1053/20 të datës 18.12.2020 **se pajtohemi pjesërisht** me mendimin e tij dhe **nuk pajtohemi** me konstatimet e nxjerrura nga AK me shkresën/vendimin e datës 08.01.2021. Sepse disa pretendime tona, eksperti nuk i ka elaboruar në tërësi, respektivisht AK me shkresën/vendimin e dërguar me datën 08.01.2021 ka dhëne sqarime në kundërshtim me kërkesat dhe sqarimet e dhëna në fazën para tenderimit nga vetë AK. AK dhe Eksperti nuk i kanë elaboruar dhe marr për bazë në tërësi dëshmitë që i kemi paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të datës 17.11.2020 dhe ankesës pran OSHP të datën 04.12.2020

• **Pretendimi nr. 1.1** nga eksperti nuk është elaboruar në detaje. konkretisht te humbjet e transformatorëve ku ka qenë kriter obligativ me pyetje sqaruese për pikën 4.1.18 Loss Capitalization

• **Pretendimi nr. 1.5** nuk është sqaruar elementi më thelbësor i ketij LOT-i ku me pyetje sqaruese dhe përgjigjet e dhëna nga AK është sqaruar se është obligativ që të plotësohet kriteri (i shënuar me ngjyrë të verdhë), si vijon: Kërkesa e AK që me pyetje klasifikuese ka sqaruar se kapitulli 4 i specifikacionit teknik është obligativ të përmbushet. Ne këtë kapitull ka qenë i përfshirë që të përmbushet kërkesa: "...current densities shall not exceed 2.7 A/mm2 in any part ot the windlngs" Plotësimi obligativ i kësaj kërkese të paraqitur më lartë ka një peshë shumë të madhe si në humbjet e transformatorëve (rreth 40%), gjithashtu edhe te kostoja financiare. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar me asnjë dokument të vetëm apo ndonjë deklaratë se plotëson këtë kriter obligativtë kërkuar. Eksperti nuk është lëshuar dhe nuk e ka sqaruar këtë pretendim tonin shumë të rëndësishëm dhe AK me qëllim favorizimi të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk është marrë fare me trajtimin dhe sqarimit të këtij pretendimi por vetëm blanko i ka pranuar specifikacionin e dorëzuar nga OE I rekomanduar për kontratë. • **Pretendimi nr. 1.6** edhe këtë pikë që ka qenë shumë e rëndësishme dhe thelbësore,

Eksperti dhe AK nuk e kanë elaboruar si duhet pasiqë shumë qartë shifet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi-referencë se ka energjizuar ndonjë transformator 110kV dhe 220kV dhe nuk ka dëshmuar se ka ndërtuar themele/ bazamente të transformatorëve HOkV dhe 220kV në tri vitet e fundit. Me qenë se natyra e këtij projekti është Furnizim dhe Punë, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar referencë për liferim të transformatorëve mirëpo nuk ka dorëzuar referencë me të cilën dëshmon se ka ndërtuar bazament/themel për instalim dhe energjizim të se paku një transformatori të nivelit HOkV dhe një transformatori te nivelit 220kV ne tri vitet e fundit, sipas kërkesës së parashtruar dhe përgjigjeve të dhëna nga AK në pyetjet sqaruese obligative, si vijon:

• Pretendimi nr. 4 (Operatori Ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK)

Ky pretendim pjesërisht është elaboruar nga eksperti sepse te pjesa e referencave Operatori Ekonomik EL-POVVER & AL FOCUS 7 SHPK nuk ka dorëzuar referencë me te cilën dëshmon se ka, liferuar, instaluar dhe ndertuar bazament/themel për instalim dhe energjizim të se paku një transformatori te nivelit 110 kV dhe një transformatori te nivelit 220 kV në tri vitet e fundit sipas kërkesës së parashtruar dhe përgjigjeve të dhëna nga AK në pyetjet sqaruese obligative, si vijon:

Nr. I Informatë shtesë/ Addltional Information Se paku një projekt te energjizuar per transformator energjetik te nivelit 110 kv dhe 220 kv ne tri vitet e fundit Një listë qe speafikon parimet re'evante të performancës	OE duhet te prcrentoi se paku nje projekt ku dëshmon se ka energjnuar një transformatorë energjetik te tensionit llOkv dhe një transformator energjetik te tensionit 220 kv ne tri vitet c fundit.

Në shkresën/vendimin e AK dt.0 8.01.2021, Al< qëllimisht mundohet ta arsyetoj OE e rekomanduar për kontratë se kinse nuk qon peshë vendosja e çmimeve në disa pozicione siç i ka cekur në shkresë, ndërsa kompaninë tonë vetëm për një pozicion i cili është ngjashëm me pozicionet që i arsyeton na eliminon nga ky aktivitet, ndërsa grupin e OE të rekomanduar për kontratë duke ja arsyetuar mos plotësimin e pozicioneve dhe pikat e tjera e shpërblen me kontratë për kundër që oferta e këtij grupi është me çmim më të lartë dhe duke përllogaritur kapitalizmin del se oferta e këtij OE është me qindra mijëra euro me e shtrenjtë se oferta e jonë me ç'rast rëndë dëmtohet buxheti i AK-së. Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që gjatë shqyrtimit të kësaj lënde ti merr për bazë pretendimet e më sipërme dhe ti shtoj në vendimin që do ta nxjerr.

Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues të ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës për LOT 4 si dhe ky aktivitet i prokurimit të anulohet, në mungesë të ofertave të përgjegjshme. Me respekt Imri Haliti.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 08.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues. (1072-1080-1083-1089-1097)

Vendim i KOSTT sh.a. në Ekspertizën me nr. 1072-1080-1083-1089-1097/20

Operatorët Ekonomik: " KONCAR KET, për LOT 1 "Ndërtimi I NS 110/10(20) kV Ferizaj 3" ;

n "Electra"- LOT 3 "Ndërtimi I Nënstacionet te Ri - AIS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV n "Doko" - LOT 3 "Ndërtimi I NS te Ri - AIS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220Kv" dhe ■ G3 Inxhiniering - LOT 3 "Ndërtimi I NS te Ri - AIS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV" 0 EI-POVVER; AL FOCUS 7 shpk - LOT 4 "Furnizimi dhe instalimi I transformatorëve të fuqisë 40MVA në NS 110/35/10(20) kV Fushë Kosova dhe NS 220/35 /10(20)kV Malisheva"; pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënie (B58) për Lotet përkatëse dhe brenda afatit te parashikuar me LPP, kanë parashtruar Ankesë (5 Ankesa) pranë OSHP-së për Aktivitetin e Prokurimit: "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP" , për LOT 1, LOT 3 dhe LOT 4, me nr. te prokurimit: Nr. iprokurimit KOSTT-20-4505-5-1-1 Nr. i brendshëm KOSTT 023/140/155/156/157/140/1-20-49-511. Ne bazë të Nenit 115 të Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë, paragrafit 1, pas pranimit te ekspertizës nga eksperti shqyrtues me date 05.01.2021, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit deklaron se: **Vendimi i AK - KOSTT sh.a. për LOT 1:**

AK-KOSTT sh.a. pajtohet me propozimin e ekspertit që AK të vazhdoj me dhënien e kontratës :

Vendimi i AK - KOSTT sh.a. për LOT 3: AK-KOSTT sh.a. nuk pajtohet me propozimin e ekspertit që AK të anuloj Vendimin për shpërblim me kontratë. Arsyet pse AK mendon se Organi i Shqyrtimit Publik duhet te mundësoi AK te vazhdoi me OE te rekomanduar janë:

OE Enbi Power ka ofertuar me çmimin ma te lire me vlere 3.281.421,87 euro ndërsa OE Electra ka ofertuar me çmimin 3.459.006,94 qe do te thotë me një diferencë prej 177.585 euro apo ne përqindje afër 6 % Pretendimet OE Electra janë bere pikërisht për pajisjet te njëjtit prodhues me te cilin ka ofertuar vet Duke u bazuar ne specifikim teknik , pajisjet ne fjale duhet te jete ne përputhje me standardin IEC 62271-1 standard për pajisjet e nënstacioneve dhe standardin IEC 62271- 100 me specifik për Ndërprerësit , OE i përzgjedhur i ka ofruar vlerat sakte sipas standardit IEC 62271-1, te kërkuar ne Tender Dosje : Pika 4.14.2 Circuit Breakers:

The circuit breakers offered shall be horizontally withdrawable vacuum types, three-pole (one drive mechanism for three phases), and three-phase auto-re-closing facilities.

They shall comply and be fully type tested to IEC 60298, IEC 62271-100, IEC 60694 and IEC 61233. Atëherë duke ju referuar nenit 5.3 te standardit ne fjale : Rated insulation level (Ud, Up, Us) te standardit ne fjale, konsiderohet se kërkesat e AK janë plotësuar. Referuar LPP Neni 28, pika 3,4 si dhe pika 9 "Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është

në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm" te cilën gjë pajisjet ofertuar nga OE i përzgjedhur e plotësojnë Te njëjtat arsye sa i përket standardit vlejnë edhe për pajisjet tjera , do te thotë se i plotësojnë sipas kërkesës se TD. Te njëjtat arsye sa i përket standardit vlejnë edhe për mospërputhshmëri e vogla ne mes te tabelave ne DT dhe standardeve te kërkuara edhe për pajisjet te cilat i janë prezantuar Ekspertit shqyrtues për mes dokumentit: Reagim ne kërkesën për rishqyrtim te OE ankues AK deklaron se te gjitha pajisjet e kërkuara për implementim te projektit janë ne përputhshmëri me standardet e kërkuara sipas DT. Po e potencoi gjithashtu kërkesën nga Zyra e Rregullatorit te Energjisë dhe KEDS-it dhe Ministrisë për zhvillim ekonomik, që implementimi i këtij projekti duhet të jetë me prioritet të lartë për shkak të reduktimeve të mëdha të energjisë në regjionin e Malishevës. Pajisjet për të cilat pretendohen se nuk janë ofruar sipas kërkesave (gjë që nuk qëndron) janë të njërit nga tre liderët absolut në botë për prodhimin e pajisjeve elektro energjetike : General Electric Grid Solution

angleze , AK konfirmon se ato mund te ndodhin për ne TD është cekur se ne raste te mos përputhshmëri ne mes gjuhëve atëherë dominon versioni ne gjuhen angleze. Vendimii AK-KOSTTsh.a. për LQT4: AK-KOSTT sh.a. pajtohet me propozimin e ekspertit që AK të vazhdoj me dhënien e kontratës. Decision of KOSTT sh.a. in Expertise with no. 1072-1080-1083-1089-1097 / 20 Economic Operators: KONCAR KET, for LOT 1 "Construction of SS 110/10 (20) kV Ferizaj 3"; "Electra" - LOT 3 Construction of New Substations - AIS 220/35/10 (20) kV Malisheva with transmission line 220kV "Doko" - LOT 3 "Construction of New SS - AIS 220/35/10 (20) kV Malisheva with transmision line 22OKv" And G3 Engineering - LOT 3 "Construction of New SS - AIS 220/35/10 (20) kV Malisheva with transmission line 220kV

EI-POWER; AL FOCUS 7 sh.p.k - LOT 4 "Supply and insta llation of 40MVA poker transformers in SS 110/35/10 (20) kV Fushë Kosova and SS 220/35 / 10 (20) kV Malisheva";

After the publication of the decision of the contracting authority for award (B58) for the respective lots and within the deadline provided by the LPP, have filed a Complaint (5 Complaints) with the PRB forthe Procurement Activity: "Supply and Installation of SS GIS, AIS, Power Transformers and LP", for LOT 1, LOT 3 and LOT 4, with no. of the procurement:

No. of procurement KOSTT-20-4505-5-1-1 Internal No KOSTT 023/140/155/156/157/140/1-20-49-511.

Pursuant to Article 115 of the Law on Public Procurement in Kosovo, paragraph *1,* after receiving the expertise from the review expert on the 05.01.2021, Responsible Procurement Officer declares that: Decision of the CA - KOSTT sh.a. for LOT 1:

CA-KOSTT J.S.C. agree with the proposal of the expert that CA to continue with the contract award: Decision of the CA - KOSTT J.S.C. for LOT 3:

CA-KOSTT J.S.C. does not agree with the proposal of the expert that CA to annul the Decision for contract award. The reasons why CA thinks that the Public Review Body should enable the CA to continue with the recommended EO are: EO Enbi Power has offered with the cheapest price with a value of 3,281,421.87 euros while EO Electra has offered with a price of 3,459,006.94 which means with a difference of 177,585 euros or in a percentage close to 6%

The claims of EO Electra are made exactly for the equipment of the same manufacturer with which it has offered itself Based on the technical specification, the equipment in question must be in accordance with IEC standard 62271-1 standard for substation equipment and IEC standard 62271-100 more specific for circuit breakers, the selected EO has provided the correct values according to IEC standard 62271-1, requested in the Tender Dossier: Section 4.14.2 Circuit Breakers: The circuit breakers offered shall be horizontally withdrawable vacuum types, three-pole (one drive mechanism for three phases), and three-phase auto-re-closing facilities. They shall comply and be fully type tested to IEC 60298, IEC 62271-100, IEC 60694 and IEC 61233. Then referring to article 5.3 of the standard in question: Rated insulation level (Ud, Up, Us) of the standard in question, it is considered that the requirements of the CA are met. Referring to the PPL Article 28, point 3.4 and point 9 "When the contracting authority has submitted the technical specification for the executive or functional requirements, it can not use the requirements such as justification for the rejection of the tender, product or service that is in compliance with a specification referred to in paragraphs 4 and 5 of this Article if such specification addresses the same enforcement or functional requirements and is appropriate." which the equipment offered by the selected EO meet The same reasons regarding the standard apply to other devices, meaning that they meet them as required by TD. The same reasons regarding the standard apply for minor inconsistencies between the tables in the TD and the required standards for the equipment which were presented to the Review Expert through the document: Reaction to the request for review of the complaining EO CA declares that all equipment required for project implementation are in accordance with the standards required by DT. He also emphasized the request from the Energy Regulatory Office and KEDS and the Ministry of Economic Development, that the implementation of this project should be a high priority due to major energy reductions in the Malisheva region. Equipment that is allegedly not provided as required (which does not stand) is one of the three absolute leaders in the world for the production of electrical equipment: General Electric Grid Solution Regarding the claim that there was an inconsistency between the Albanian and English language, CA confirms that they can occur for us TD it is stated that in cases of inconsistency between thelanguages then the English language version dominates. Decision of the CA - KOSTT sh.a. for LOT 4:CA-KOSTT J.S.C. agree with the proposal of the expert that CA to continue with the contract award. Me respekt, Abdulsatar Ibrahimi.

Operatori Ekonomik: "Electra"SH.P.K- Graçanicë, me datë 05.01.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar, Sot me date Tuesday, January 5, 2021 9:50 AM, kemi marr email nga OSHP lidhur me ankesën te cilën e ka bere Electra sh.p.k për projektin: "Furnizimi dhe Instalimi I NS GISS,AIS,Transformatorve Energjetik dhe LP" me Nr KOSTT -20-4505-5-1-1, LOT-3

Me vëmendje lexuam shqyrtimin dhe analizën qe eksperti I OSHP I ka bere lendes për te cilën kemi bere ankese ndaj vendimit te AK KOSTT për shpalljen e fituesit "ENBI POWER"

Nga përgjigja qe kemi marre nga eksperti shqyrtues konstatojmë se eksperti ka bere vlerësimin sipërfaqësor duke mos u lëshuar ne vërejtjet tona konkrete për te cilat janë te argumentuara ne çdo pike veç e veç . Konsiderojmë se pika 1 e ankesës se Electra për qeshtjen e varijaneteve është njëra prej pikave me te rëndësishme te projektit për te cilën ka te beje me mbrojtjet e pajisjeve dhe mbrojtjen e personelit qe janë Mbrojtjet Rele , Kontrolli dhe menaxhimi I tere sistemit qe k atë beje me SCADA, prandaj konstatojmë se Eksperti ne mungese te njohurive te mjaftueshme te funksionimit te sistemit te tille nuk ka vlerësuar drejt duke e trajtuar si "Pajisje jo shume te rëndësishme " e cila ne fakt këto pajisje marrin pjese diku ne vlere afër 20% ne total projektin, prandaj pajisjet ne fjale janë pjesa me e rëndësishme e projektit. Eksperti shqyrtues nuk ka qene ne gjendje te identifikoj se pajisjet e ofruara për pjesën kryesore (MAIN Protection) ka ofruar dy prodhues te ndryshëm(SIEMENS ose GE) , kurse për "back up"(reserve) protection e qe janë vetëm dy mbrojtje , njëra është Mbrojtje distance e Linjës dhe tjetra është Mbrojtje diferenciale e Transformatorit , ne këtë rast kërkohet qe prodhuesi te jete I ndryshëm nga ato I mbrojtjeve kryesore , po jo te dy paret te ofrohen nga dy prodhues si me rastin qe OE ENBI POWER I ka Ofruar. Po ashtu ne vijim kemi ofruar edhe shume argumente te bazuara për mospërmbushje te specifikimeve teknike te cilat te dhëna janë obligative ne Dosjen e Tenderit.

Vërejtjet e tilla janë konstatuar edhe nga operatoret te tjerë ankues , andaj përgjigja e ekspertit e cilësuar si pjesërisht e pranuar për ne janë te pakuptimta. Sugjerimi I tije qe te anulohet procedura me arsyetimin duke u referuar ne spec teknike te dosjes se tenderit e ne disa raste standardeve te aplikueshme , për këtë rast mendojmë qe LPP I qartëson shume qarte procedurat dhe shpjegon se cilat nga kriteret janë obligative për OE. Andaj Kompania Electra sh.p.k nuk pajtohet me vlerësimin e Ekspertit Shqyrtues ku sugjeron qe te anulohet proceduara e Prokurimit Publik për LOT-3,meqë nga AK ne kuadër te kompanive pjesëmarrëse jemi kualifikuar te përgjegjshëm , kërkojmë nga Bordi I OSHP qe te vazhdoje me procedurat e mëtutjeshme dhe te kalohet te OE I pergjegjeshem me radhe qe ne këtë rast është Kompania Electra sh.p.k.

Për te gjitha pretendimet tona te paraqitura me shkrim ne jemi te gatshëm ti arsyetojmë para çdo paneli shqyrtues I cili është I përcaktuar me ligj. Me respekt/Best Regards! Lutfi Gashi Gr.El.Eng.

Operatori Ekonomik: "Konqar-Inzeniering za Energetiku i Transport"D.D-Zagrep, me datë 04.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Dear Sirs, We hereby confirm the recipe of the expert report in Albanian language. However we would kindly as if you can share the expert report on claims in English language as well for our full understanding. Due to the fact that we have received the documents only in Albanian and that we are in the festive period of holidays we would kindly ask to give us additional period for submitting our response on the subject matter (4 days after we receive the document in English would be appreciated). Thank you in advance. Best Regards,

Te nderuar zoterinj, Me anë të kësaj ne konfirmojmë pranimin e raportit të ekspertit në gjuhën shqipe. Sidoqoftë ne do të donim me mirësi sikur të mund të ndani raportin e ekspertit mbi pretendimet në gjuhën angleze gjithashtu për kuptimin tonë të plotë. Për shkak të faktit që ne kemi marrë dokumentet vetëm në gjuhën shqipe dhe se jemi në periudhën festive të pushimeve, me mirësi do të kërkojmë të na jepni një periudhë shtesë për dorëzimin e përgjigjes sonë për këtë temë (4 ditë pasi të marrim dokumentin në anglisht do të vlerësonim). Ju falenderoj paraprakisht.

Përshëndetjet më të mira,

Operatori Ekonomik: "G3 Engineering"SH.P.K-Fushë Kosovë, me datë 08.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Doko"SH.P.K-Elbasan, me datë 08.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

I Nderuar Z.Dina. I referohemi raportit te ekspertit shqyrtues Zt. Kurtishaj lidhur me Ankesën nr. 1089 / 20, për prokurimin e kontestuar: Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP, Lot 3, me nr. 20 - 4505 - 5-1-1, i iniciuar nga KOSTT.

Sipas mendimit profesional te Kompanisë sonë ,pas shqyrtimit dhe analizimit te Raportit te Ekspertit Shqyrtues ,konstatojmë se Zt. Kurtishaj, ka bere një vlerësim pjesërisht objektiv dhe jo te plote. Gjithashtu, Zt. Kurtishaj, jep përgjigje ne te gjitha pretendimet ankimore te ofertueseve tjerë duke u shtjelluar ne thelbin e kontestit te argumenteve ligjore kurse ne rastin e Kompanisë sonë jep përgjigje vetëm ne dy pretendime ankimore pa u shtjelluar ne thelbin e argumenteve te prezantuara ligjore me arsyetim ligjor. Si Kompani ankuese nuk pajtohemi me ekspertin shqyrtues qe thirret ne nenin 39 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik për arsye se Oferta e Kompanisë 'DOKO' sh.p.k, i është përmbajtur ne tërësi specifikimeve teknike te detyrueshme te Aneks 1 te dosjes se tenderit dhe sipas nenit 28 te Ligjit te Prokurimit Publik me nr. 04 / L - 042 dhe ka dorëzuar 'te gjitha Katalogët e nevojshme' por esenca e mos pajtimit me Autoritetin Kontraktues ka qene mos përcaktimi i kërkesës (parametrat teknike

për Terminalet e Kaplove) ne aspektin ligjor dhe ne aspektin teknik ne specifikacionin teknik te detyrueshëm për terminalet e kabullit te tensionit te mesëm. Nuk është i vërtetë arsyetimi dhe konstatimi i ekspertit shqyrtues ku cek ne Raportin e tij te Ekspertizës qe mungon specifikacioni teknik për pajisje apo nuk ofrohen komplet te dhënat ne Oferte duke u thirrur ne nenin 39 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik ngase siç kemi potencuar qarte ne Ankese se te dhënat për te cilat jemi eliminuar padrejtësisht nga Autoriteti Kontraktues nuk janë 'specifikuar ligjërisht', as ne specifikacionin teknik te detyrueshëm ne Ri-theksojme faktin ligjor qe ne Ankesë 1 - specifikimet teknike te detyrueshme, si pjese e dosjes se tenderit nuk ka pasur 'asnjë kërkesë minimale nga KOSTT' për Terminalet e Kaplove te Tensionit te Mesëm.

Është me rendësi te potencojmë dhe te informojmë Panelin Shqyrtues te OSHP-se qe mos specifikimi i Kërkesës për 'PARAMETRAT MTNIMALE TEKNIKE' qe duhet te i përmbajnë

këto Terminale qe Autoriteti Kontraktues është dashur te i specifikonte ne mënyrë ligjore dhe teknike ne Dosje te Tenderit tek Aneksi 1 - Specifikacioni Teknik i Detyrueshëm, është e padrejte dhe jo ligjore qe Oferta e Kompanisë 'DOKO' sh.p.k, te eliminohet nga konkurrenca dhe te shpallet Oferte e pa-përgjegjshme nga Autoriteti Kontraktues por njëkohësisht është edhe e padrejte dhe jo ligjore te mos vlerësohet drejte dhe sakte edhe nga Eksperti Shqyrtues, Zt. Kurtishaj, ne raportin e tij te Ekspertizës. Si rrjedhoje, as Autoriteti Kontraktues, por as edhe Eksperti Shqyrtues, nuk mund te thirren ne nenin 39 te Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik por është dashur te kërkojë sqarim ligjor te Ofertës sonë teknike për Kabullin e Tensionit te Mesëm ngase Oferta jone është e përgjegjshme dhe ne pajtim te plote me kërkesat minimale dhe maksimale te një produkti, ashtu siç është kërkuar ne Fletën e te Dhënave te Tenderit dhe ne Specifikacionet Teknike te Detyrueshme, si pjese e dosjes se tenderit për tenderin e kontestuar.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues, ka pasur për obligim ligjor sipas nenit 59 dhe sipas nenit 72 te Ligjit te Prokurimit Publik me nr. 04 / L - 042, te kërkojë sqarime ligjore për Kabullin e Tensionit te Mesëm nga Kompania 'DOKO' sh.p.k ngase me Oferte është dorëzuar Data Sheet - Fleta e te Dhënave për parametrat teknik te Kabullit te Tensionit te Mesëm. Sa i përket Terminaleve te kabllove te tensionit te mesëm, e ri-përsërisim qe nuk ekziston ne specifikimet teknike, si pjese përbërëse e dosjes se tenderit, asnjë kërkesë minimale nga KOSTT.

Nëse vërtetë mendoni se Pretendimi Ankimor i Kompanisë 'DOKO' sh.p.k, është i pabazuar, jeni te lutur te na dërgoni Kërkesat Minimale dhe Maksimale te Autoritetit Kontraktues për Terminalet e Kabllove te Tensionit te Mesëm, te cilat duhet te jene pjese integrale e dokumenteve te tenderit. Gjithsesi, për çdo klasifikim te mëtutjeshëm për te gjitha parametrat teknike te këtij Produkti. Autoriteti Kontraktues, ka pasur detyrim. ligjor te kërkojë sqarim ligjor nga Kompania 'DOKO' sh.p.k por një akt te tille nuk e kane bere. Ne anën tjetër, pajtohemi me ekspertin shqyrtues qe e konsideron te bazuar pretendimin e dyte ankimor qe Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigje ne asnjë nga

argumentet tona ligjore ne Kërkesën për Rishqyrtim edhe pse ka pasur obligim ligjor te ktheje përgjigje ne çdo argument ligjore te palës ankuese, ashtu siç kërkohet me nenin 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik me nr.

04 / L - 042. Gjithashtu, Kompania 'DOKO' sh.p.k, njofton Panelin Shqyrtues, qe Eksperti shqyrtues ka pasur obligim ligjor te ofronte përgjigje ne te gjitha pretendime tona ankimore, te potencuar ne Ankese,ashtu siç kërkohet ne nenin 113 dhe 114 të ligjit të prokurimit Publik me nr. 04/L-042 por ka ofruar përgjigje vetëm ne dy pretendime ankimore qe padrejtësisht ka diskriminuar Kompaninë DOKO SH.P.K ne ofrimin e përgjigjes se tij ne te gjitha pretendimet tona ankimore dhe për te argumentuar ne aspektin ligjor dhe ne aspektin teknik thelbin e kontestit me Autoritetin Kontraktues. Kompania 'DOKO' sh.p.k kërkon nga Paneli Shqyrtues te OSHP-se te ndryshoje Mendimin e Ekspertit Shqyrtues Teknik dhe te bazohet ne argumentet tona ligjore te prezantuara ne Ankese dhe te konsideroje Ofertën e Kompanisë 'DOKO' sh.p.k plotësisht e përgjegjshme qe është ne pajtim te plote me kërkesat teknike dhe ligjore te potencuar ne Dosje te Tenderit. Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se, te miratoje si te bazuar Ankesën tone ne OSHP dhe lenden e kontestuar te dërgoje ne Ri-Vlerësim te Ofertave. Përfaqësuesit e Kompanisë sonë janë ne dispozicion ne çdo kohe për ofrimin e sqarimeve ligjore për argumentet tona ligjore te prezantuara ne Ankese ose për pjesëmarrje ne seancën dëgjimore nëse organizohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit. Me nderime Fatbardh DOKO.

From: Ivan Tomšić <ivan.tomsic@koncar-ket.hr>
Sent:12/Jan/2117:21
To:OSHP<oshp@rks-gov.net>
Cc:prokurimi@kostt.com; Merita Zharku <merita.zharku@kostt.com>; abdulsatar.ibrahimi@kostt.com; Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi <Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>; Goran Milenkovic <Goran.Milenkovic@rks-gov.net>; muhamet kurtishaj <muhamet.kurtishaj@gmail.com>; Boris Brestovec <Boris.Brestovec@koncar-ket.hr>
Subject: RE: 1072,1080,1083,1089,1097/20 Ekspertiza

Dear Members of the Panel of the Procurement Review Body,

We do not agree with conclusions and the opinion of the expert for our claims in the complaint Nr 1072-1080-1083-1089-1097/20.

On Claim no2. we have clearly explained that the offered references are not compliant with the request of the Contracting Authority, yet the contracting authority and the expert have 'justified' their acceptance illegally. We think this is a major point and, on this basis, alone the whole LOT should be canceled since there are no compliant offers.

Regarding claim nr. 4, the expert has clearly misunderstood the claim that we are making. Our claim simply compared the different treatment that two companies are getting in the same tendering procedure – in the same project. On LOT 1, ABB is 'forgiven' for not completing the technical specifications page, while on LOT 3, the same contracting authority applies a different measure, whereby eliminating the company DOKO for the same mistake. This is in clear violation of article 7 of the procurement Law where the Contracting Authority has used double standards to evaluate offers. The expert has not fully understood the claim, and furthermore they have made assumptions that are clearly for the purpose of misleading the panel. We have never claimed that DOKO participated in LOT 1, but we have claimed that the contracting authority is applying a double standard when it comes to evaluating our offer.

We do not agree with conclusions on our claims that the expert has given an opinion on and we do not accept their opinion to be valid. Therefore, we are asking for the Review Panel to carefully examine our claims and make an informed decision on our claims during the Panel hearing.

We are looking forward to the Panel hearings.

Best Regards,

mr.sc. Ivan Tomšić, dipl.ing.el.
Član Uprave / Board Member

Končar – Inženjering za energetiku i transport d.d.
Končar – Power Plant and Electric Traction Engineering Inc.
Fallerovo šetalište 22, 10000 Zagreb, Croatia
GSM: +385 99 2192 919
fax: +385 1 3667 515
e-mail: ivan.tomsic@koncar-ket.hr
web: www.koncar-ket.hr

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit per dhnie te kontrates per LOT 1,3 dhe 4.

Paneli shqyrtues sqaron se me poshtë janë dhen sqarime per pretendimet ankimore te OE "Ballkan Petrol"SH.P.K-Ferizaj LOT 4:me numër te protokollit 1053/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit :Furnizimi dhe Instalimi i Ns gis ,ais Trandsformatoreve Energjitike dhe LP Lot 4 "Furnizimi dhe Instalimi i informatorëve te fuqisë 40MVA ne NS 110 35 10 (20) kv Fushë Kosovë dhe NS 220 35 10 (20)kv Malishevë, ku i rekomanduar për dhënie te kontratës për Lot 4 është OE HAEM ENER ELEK.ELEKT. MUHEN.DANIS .INS TAAH.IÇ VE DIS TIC .SAN.LIMIT . SIRKETI Dega në Kosove; ASTOR TRANSFORMATOR , në vlere prej 1.465.849.10€;

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nga qasja në dokumente kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues / Komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave conform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar ofertat në menyrë të barabartë sepse neve na kanë eliminuar me arsytimin se nuk e kemi plotësuar çmimin te kpozicioni 1 te "Programi 2"-punet inxhinierike për një vlerësim simbolike rreth 2 apo 3 mijë euro pa gjetur asnjë fakt tjeter që na mungon në ofertën tonë, ndërsa ka rekomanduar për kontratë grupin e OE HAEM & ASTOR ku nëse merret diferenca e çmimit si dhe kapitalizimin obligativ (të cilin do ta elaborojmë më vonë) del se AK ka shperblyer me kontratë një OE I cili ka çmim më të lartë rreth 84,748.00 € në ofertë financiare si dhe në kapitalizimin e humbjeve obligativ rreth 182,000.00€ ku së bashku në total 84,748.00 € + 182,000.00€ = 266,748.00 € (çmimi dhe kapitalizimi total), në krahasim me oferten financiare të dorëzuar nga kompanai jonë Ballkan Petrol SHPK.
Nëse e marrim këtë diferencë të çmimit, si është e mundur që kompania e jonë të eliminohet për një pike të vetme ndërsa AK të rekomandon për kontratë OE HAEM & ASTOR pa analizuar dhe konstatuar mangësitë e shumta që ka në ofertën financiare si dhe në dëshmitë tjera tëc ilat nuk i ka conform kërkesave dhe dëshmive të parashtruaranga AK në njfotimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
Paneli shqyrtues konform eksperitti shqyrtues teknik konstaton se operatori ekonomik ankues është elimnuar sepse nuk e ka plotësuar çmimin tek pozicioni 1 te "Programi 2"- pozicioni 1." Analiza e shpimeve te tokes dhe pergatitja e terrenit "– për ketë nuk ka ofruar çmim.Mirëpo, Autoriteti Kontraktues / Komisioni i

vlerësimit duhet të bej vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke i trajtuar të gjithë OE në menyrë të barabartë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se -Tek tabela e përshkrimit të çmimeve, pjesa elektrike, kolona "*construction/erection, commissioning*", pozicioni 1.2; 2.2; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 4.1; 4.2; 4.3; 4.4, si dhe te pjesa e punimeve inxhinierike, kolona e punëve, pozicioni 1, OE HAEM & ASTOR nuk ka dhënë çmim fare dhe për pozicionet që kanë qenë obligative të plotësohen, OE HAEM & ASTOR nuk i ka plotësuar.
Përçudi ne si OE eliminohemi vetëm për njëpozicion, kurse OE I rekomanduar për kontratë edhe pse nuk ka plotësuar tabelat që kanë qenë obligative në 11 pozicione (rubrikë e çmimeve) I njejti propozohet të shpërblehet me kontratë.
Më poshtë paraqesim disa pjesë të tabelave respektivisht të ofertes te pozicioni 1 të OE HAEM & ASTOR e cila nuk e ka plotësuar tabelën "Programi 2" në pozicioinin 1 "Analiza e shpimeve të tokës" ka dhënë çmim, ndërsa në të njejtin pozicion " Përgaditja e terenit" , e cila është punë, nuk ka dhënë çmim fare. Për të njejtin detal ne jemi eliminuar duke e arsyetuar se është në kundërshtim me nenin 39.8 të RRUOPP.
Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues-teknik konstaton se tabela e përshkrimit të çmimeve, pjesa elektrike, kolona ***"construction/erection, commissioning EURO"***, përpozicionet: 1.2; 2.2; 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; 4.1; 4.2; 4.3; 4.4, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë çmim për pozicionet e lartë cekura, është në kopetencën e autoriteti kontraktues të sqarojë lidhur me përshkrimin e çmimeve pasi ka paqartësi rreth kësaj, të cilat pretendime nuk i ka shqyrtuar edhe në ankesën për Ri-shqyrtim te operatorit ekonomik ankues, poashtu autoriteti kontraktues eleminon operatorin ekonomik ankues me arsyetimin se të "Progarmi 2" Programi 2"- pozicioni 1. "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergatitja e terrenit",i cili është elimnuar pasi nuk ka ofruar çmim për ketë pozicion, ndërsa për të njejtin pozicion operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotsuarkolna "Work/EURO", AK-komisioni i vlersimit nuk ka vepruar konform nenin 59, të LPP, gjatë procesit të vlersimit, ekzaminimit dhe krahsimit të ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Po ashtu, Sipas Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik - 41.15 Ne rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet qe të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro. 1. Nëse Operatori Ekonomik pranon se ai artikull i veçantë nuk është i përfshirë në tender, tenderi duhet të refuzohet. 2. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.AK-ja, komisioni i vlersimit nuk ka berë trajtim të barabartë të operatorve eknomik. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se po ashtu OE HAEM & ASTOR në ofertën e tij financiare ka bërë

gabim në llogaritje të çmimeve, të cilat tejkalojnë ±2%, ndërsa AK / komisioni I vlerësimit nuk e ka analizuar dhe nuki ka konstatuar këto gabime.

AK në dosjen e tenderit ka hartuar tabelën e përshkrimit të çmimeve ka kërkuar për secilin pozicion që çmimet në ofertë të vendosen me DDP (që nënkupton më të gjitha taksat – përfshirë TVSH)nga e cila tabelë shihet se edhe totali I ofertës është dashur të rrjedh nga çmimet për pozicione së bashku me TVSH, ndërsa OE HAEM & ASTOR ka llogaritur normën e TVSH ekstra edhe tek tabela për mbledhëse nga kjo rrjedh se ky OE TVSH e ka kalkuluar dyfish në ofertën e tij, si dhe ky kalkulim ndryshon nga kalkulimi I bërë në ofertën e dorëzuarnga ne, OE BallkanPetroll SHPK si dhe kalkulimi I ofertës nga OE ENBI POWER shpk, si dhe në kundërshtim me kërkesën e vetë AK.

Më poshtë e kemi paraqitur tabelen e përshkrimit të çmimit- Përmbledhjen e OE HAEM & ASTOR ku konstatohet se I njejti ka kalkuluar dy here TVSH-në:

Tabela "Schedule 1" ka vlerëntotale DDP 1,124,035.00€ (1,060,035.00€ + 64,000.00€)

Tabela "Schedule 2" ka vlerëntotale DDP 118,210.00€ (92,426.00€ + 25,784.00€)

Totali i dy tabelave DDP përfshirë TVSH është **1,242,245.00€** e jo siq e ka paraqitur OE HAEM & ASTOR **1,465,849.10€,** pra ndryshimi i çmimit tejkalon 2% e vlerës së lexuar në hapje të oferatave dhe është dashur të veprohet konform nenit Neni 59, paragrafi 3.

Shembull: Në tabelën më poshtë kemi paraqitur në formë tabelare kalkulimin e çmimeve, respektivisht se si ish dashur të llogaritej oferta financiare OE HAEM & ASTOR si me larte.

Nga dëshmitë e lartë cekura mund të konludojmë se diferenca respektivisht gabimet aritmetikore në ofertën e OE HAEM & ASTOR janë në vlerë prej 223,604.10 € nga e cila vlerë konstatohet se ka gabime mbi normën ±2%, të vlerës totale të ofertës.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në listen e përshkrimit të çmimeve, normën e TVSH-së e ka aplikuar dy herë, nese TVSH-ja është më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës, nuk konsiderohet si gabime aritmetikore, sipas KRPP-së Ndimesë- pyetjete e shpeshta pika 46 thuhet:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime

shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor që ka te bej me: Po ashtu tek oferta financiare OE HAEM & ASTOR, në tabelën e përshkrimit të çmimeve për pjesën 4 Spare Parts çartë shifet se OE HAEM & ASTOR ka ndërhyrë në tabelën e përshkrimit të çmimeve dhe ka shtuar pjesë të cilat ndryshojnë formën origjinale të tabelës së përshkrimit të çmimeve.

Paneli shqyrtues konform eksperiti shqyrtues –teknik konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në tabelën -Programi 1 të përshkrimi i çmimeve për pjesën 4 Spare Parts(Pjeset rezerve), ka berë ndërhyrje të përshkrimi tek pika 4 Pjeset rezerve, pika 4.1, 4.2, 4.3, 4.4,

Tabela -Programi 1 sipas dosjes se tenderit.

4.	Spare Parts		
4.1	110 kV transformer oil bushing	pcs	1
4.2	220 kV transformer oil bushing	pcs	1
4.3	10(24) kV transformer bushing	pcs	1
4.4	35 kV transformer bushing	pcs	1

Tabela- Programi 1 e plotsuar nga OE i rekomanduar për kontratë me nderhyrje .

4.	Spare Parts		
4.1	110 kV transformer oil bushing - code 550 800A TRENCH	pcs	1
4.2	220 kV transformer oil bushing - 1050 800A TRENCH	pcs	1
4.3	10(24) kV transformer bushing 20NF 630 Ankara Seramik	pcs	1
4.4	35 kV transformer bushing 30 NF 1000 Elmek	pcs	1

Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bej me: Gjithashtu OE HAEM & ASTOR me rastin e dorëzimit të ofertës ka ofruar specifikacion teknik i cili nuk është konform dosjes së tenderit respektivisht sqarimeve të bëra nga AK përmes pyetjeve dhe përgjigjjeve të dates 24.09.2020 ku AK ka bashkangjitur në platformen e E-prokurimit verzionin 2-Technikal data të azhuruar/përmisuar. Ndersa ky operator ekonomik ka nderyhyrë në specifikacioni technical data duke bartur shënime nga verzioni 2- sqarimi i tenderit dhe duke inkorporuar në verzionin 1.1 të dosjes së tenderit (i cili është korigjuar me sqarimet e paraqitura nga AK në platformën e E-prokurimit-verzioni 2 dt.24.09.2020), më konkretisht ky operator ekonomik ka dorëzuar së bashku me

dosjen e tenderit specifikacionin e verzionit 1.1 e jo verzionin 2 të korigjuar nga AK si dhe në verzionin 1.1 ka tentuar të inkorporoj specifikacionin sipas verzionit 2 mirëpo duke lën mangësi të shumta e në veqanti në pozicionin 25-te humbjet e trafos e ka lën përshkrimin e verzionit të vjetër(1.1) që ka qenë në maksimum 211, kurse në verzionin e ri (2) me sqarime ky pozicion është përshkruar vetëm 211-pa maksimum.(me përshkrimin 211 lejohet tolerancë + me standarde according to IEC standard, ndërsa me verzionin e vjetër maksimum 211 nuk lejohet tolerancë + me standarde according to IEC)

Paneli shqyrtues konform ekspertiti shqyrtues –teknik Eksperti shqyrtues sqarone se pas sqarimeve shtese përmes pytjeve/përgjegjie të datës 24.09.2020 autoriteti kontraktues ka ndryshuar specifikacioni nga "verzioni1.1" në "verzionin 2", ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofertuar sipas verzionit 1.1, andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bej me: Po ashtu grupii OE HAEM & ASTOR nuk ka dëshmuar se ka referenca se ka energjizuar transformator 110kV dhe 220kV dhe nuk ka dëshmuar se ka ndërtuar themele/bazamente të transformatorëve 110 kV dhe 220 kV në tri vitet e fundit, por ka dorëzuar referenca për liferimin e transformatorëve dhe me këtë nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Në përgjigje të pyetjes sqaruese "add informNo 5-part one" ne fq. 54/70 është sqaruar se O.E. duhet të këtë bërë ndërtimin e bazamentit/themelit, instalimin dhe energjizimin e së paku një transformatori të nivelit 110 kV dhe një transformatori të nivelit 220 kV në tre vitet e fundit.

Paneli shqyrtues konform eksperiti shqyrtues-teknik konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofruar "List of delivered Transformers si dhe referenca për transformatoret të natyrës se ngjajshme, mirëpo autrotiet kontraktues mund të kerkoje sqarime lidhur me referenca e ofruar për transformatore.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që kan të bejn me:- Nga ndarja e punëve dhe përgjegjësive në marrëveshjen e konzorciumit shihet:

ASTOR TRANSFORMATOR dizajnon dhe prodhon transformatorët, ndërsa HAEM ENERJI – BRANCH IN KOSOVA koordinon punët e ndërtimtarisë dhe paguan taksat.

ASTOR TRANSFORMATOR shall do the design and manufacturing of the power transformers, whereas HAEM ENERJI – BRANCH IN KOSOVA shall coordinate civil works and pay import duties and local taxes and hereby do the invoicing to the Contracting Authority.

Konstatim:

Refrencat e dorëzuara nuk janë complete pasi që prodhuesi ASTOR TRANSFORMATOR ka prodhuar dhe liferuar transformatorë, ndërsa nuk ka dorëzuar referenca për punët si ndërtimin e bazamentit/themelit, instalimin dhe energjizimin e transformatorëve.

Paneli shqyrtues konform eksperitti shqyrtues –teknik konstaton se sipas RrOUPP - 27. Grup i Operatorëve Ekonomik, 27.3 Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-se. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-se do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.Prandja, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferten e tij ka ofruar marrveshjen e konzerciumit mes antarëve të gruopit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik nakues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit që ka të bej me: - Vlerësojmë se project menaxheri Z. Eldar Mammadov nuk e plotëson kriterin e kërkuar, citoj: "Menaxheri I Projektit duhet te kete se paku 5 vite pervoje pune te natyrës se ngjashme, dhe njohje te rrjedhshme të gjuhës Angleze. Deklarata e nënshkruar mbi përmbushjen e kërkesës".

Nga diploma e Z. Eldar Mammadov shihet se ka diplomuar në Bachelor në shkencat e inxhinjeri së Mekanike me dt. 13.06.2015. Nga data e diplomimit 13.06.2015 derite data e hapjes se ofertave 06.10.2020 janë 5 vite 3 muajdhe 23 ditë, periudhë e cila mund të merret si pervojë e punes.

Në dokumentet e pranuara nga ju askund nuk kemi parë se keni verifikuar vërtetësinë e deklaratës rreth Projekt Menaxherit se ka sëpaku 5 vite përvojë pune të natyrës së ngjashme.

Nëtëgjithashtetetdihet se pas diplomimitrespektivishtpunesimitsëpaku 6 deri 12 muajduhettëketëpunëpraktike, pastajteemërohetnëpozitaadekuatedhetëmveshet me përgjegjegjësi.

Menaxhimi i projekteve të punëve me natyrë të ngjajshme kërkon jo vetëm shkollim por edhe pervojë të gjatë, të cilën PM nuk e posedon.

Vlerësojmë se deklaratapërpërvojën e menaxherittëprojektitnukështë e vërtetëdhejuvesi A.K. ju ka futnëlajthitje, nëkëtërast O.E. ka shkelurDeklaratennënbetim.

Kërkojme që ky fakt të verifikohet gjatë procesit të Ri-vleresimit.

Paneli shqyrtues conform ekspertiti shyqrutes –teknik konstaton është kopetencë e autoriteti kontraktues të verifkojë project menaxheri z.E.M. Diploma e Z. Eldar Mammadov, ka diplomuarnë Bachelor në shkencat e inxhinjerisëMekanike me dt. 13.06.2015. Nga data e diplomimit 13.06.2015 derite data e hapjes se ofertave 06.10.2020 janë 5 vite 3 muajdhe 23 ditë, periudhë e cila mund të merret si pervojë e punes.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Afati I validitetit të ofertës nuk është korrekt, është kërkuar "Periudha e vlefshmërisësëtenderit **90** ditë", në formular tëtenderit ka deklaruar: "Ky tender është valid për

një periudhë prej **15.01.2021** osemuaj: oseditë: nga data finale për dorëzim të tenderëve.", kjo fjali mund të interpretohet por në thelb nuk ka kuptim.

Ne nenin 7, Pjesa I. Formulari i Tenderit është e cekut "Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK".

Paneli shqyrtues konform eksperitit shqyrtues teknik konstaton se periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë, ose ___muaj, ose deri në datën____.Ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar periudhen e vlefshmërisë e ka ofruar , 4. Ky tender është valid për një periudhë prej 15.01.2021 ose muaj: ose dite: nga data finale për dorëzim të tenderëve.Prandaj, periudha e vlefshmërisë së tenderit e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është konform dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e ankueisit se nga qasja në dokumente kemi vërejtur se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave conform nenit 7 dhe 59 të LPPsë duke mos I trajtuar ofertat në mënyrë të barabartë sepse neve na kanë eliminuar me arsytimin se nuk e kemi plotësuar çmimin tek pozicioni 1 itabelës për punët inxhinierike ndersa tek OE EMTA nuk është lëshuar në vlerësimin të detajuar.

Këtë e themi për arsye se OE EMTA përveq se nuk e ka plotësuar pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshktimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar ne, gjithashtuky operator ka shumë defekte tjera si në tejkalim të buxhetit, gabim në përllogaritjen e çmimeve, në referenca, etj, për Autoritetin Kontraktues është cilësuar se nuk është ipërgjegjshëm vetëm për tejkalim të buxhetit pa u lëshuar në vlerësim më të detajuar.

Si fakt paraqesim tebelen e plotësuar nga OE EMTA ku shihet se edhe ky operator ekonomik nuk e ka plotësuar të njëjtin pozicion sikurse edhe ne:

Paneli shqyrtues conform Ekspertit shqyrtues-teknik konstaton se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik EMTA për të njejtin pozicion nuk ka ofruar çmim, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE EMTA duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuksseshme.

Tabela: Programi 2 pozicioni 1 nuk është plostuar nga OE EMTA.

Schedule 2: Design and Construction of Civil Works							
	Description	Unit	Quantity	Unit price DOP EUR	Total price DOP EUR	Works EUR	Total costs EUR
1.	Soil investigation and site preparation		lump sum				
2.	Fushe Kosova 110/35/10(20) kV Substation						

Andaj, pertendimi ankimore I opertaorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Edhe te ***operatori Ekonomik ENBI POWER SHPK*** , Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit në raportin e vlerësimit dhe letrën standarde e ka cilësuar se është i përgjegjshëm administrativisht, vetëm kinse I njëjti e ka tejkaluar buxhetit pa u lëshuar në vlerësimin e detajuar.

Edhe ky OE nuk ka plotësuar pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshkrimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar edhe ne.

Gjith ashtu ky operator nuk I plotëson edhe referencat e kërkuara dhe ka vërej tjetjera në ofertën e tij.

Si fakt paraqesim tebelën e plotësuar nga ENBI POWER SHPK ku shihet se edhe ky OE nuk e ka plotësuar të njëjtin pozicion sikurse edhe ne.

Paneli shqyrtues conform Ekspertit shqyrtues-teknik konstaton se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik ***ENBI POWER SHPK*** për të njejtin pozicion nuk ka ofruar çmim, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE ***ENBI POWER SHPK*** duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuskseshme.

Schedule 2: Design and Construction of Civil Works							
	Description	Unit	Quantity	Unit price DOP EUR	Total price DOP EUR	Works EUR	Total costs EUR
1.	Soil investigation and site preparation		lump sum				
2.	Fushe Kosova 110/35/10(20) kV Substation						

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Te Operatori Ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur të përgjegjshëm dhe vetëm ka thënë se çmimi i tij ka qenë më i lartë. Autoriteti

Kontraktues / komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin detaj të këtij operatori ku i njejti ka shumë defekte në ofertën e tij e për çudi AK edhe këtë operator e shpall të përgjegjshëm administrativisht.

Edhe ky OE nuk e ka plotësuar në tërësi pozicionin 1 te pjesa e punimeve inxhinierike në tabelën e përshkrimit të çmimeve, pozicion për të cilin jemi eliminuar ne dhe i cili pozicion në tabelë ka qenë obligativ të plotësohet dhe OE ka qenë i obliguar që çdo pozicion në tabelë ta plotësoj konform kërkesës së AK dhe nenit 39.8 të RRUOPP(shif tabelën e mëposhtme) .

Tabela: Programi 2-pozicioni 1 - **EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK**

	Programi 2: Dizainimi dhe Ndërtimi i Punëve inxhinierike						
	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi DDP EURO	Çmimi në total DDP EURO	Punët EURO	Kostoja totale EURO
1.	Analiza e shpimeve te tokës dhe përgatitja e terrenit		paushall			10,000.00	10,000.00
2.	[illegible]						
	Të gjitha themelet do të kompletohen me çdo aspekt dhe duhet të jenë si betonit të armuar duke përfshirë betonin e ligët sipas kërkesave statike, hetimin e tokës, shtresën përfundimtare dhe rimbushjen e tokës						
2.1	Për transformatorin e ri te energjisë 110/35/10 (20) kV, 40 MVA dhe te ardhmen 110/20 (20) kV, 40MVA	copë	2	18,000.00	36,000.00	2,000.00	38,000.00
2.2	Ndërtimi i sistemit si ri ndarësit [illegible]	copë	1	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]

Paneli shqyrtues conform eksperitit shqyrtues-teknik konstaton se se Autoriteti Kontraktues / Komisioni I vlerësimit nuk ka bërë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së duke mos i trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë, për arsyjen se operatori ekonomik ankues është elimunuar për të njejtin pozicion "Programi 2 pozicioni 1 "Analiza e shpimeve te tokes dhe pergaditja e terrenit" i cli nuk ka ofruar çmimi për ketë pozicion, ndësa operatori ekonomik ***EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK*** për të njejtin pozicion nuk ka plotsuar çmim" **çmimin në total DDP EURO**" është kopetence e autoriteti të sqarojë rreth përshkrimit të çimeve, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes se OE ***EL-POWER & AL FOCUS 7 SHPK*** duke e njoftuar për mes Letres standarte për tenderuesin e pasuksesshëm, se oferta juaj e tejkalon buxhetin e parashikuar për ketë projekt, autoriteti konrtaktues nuk ka berë vlersimin e ofertës nga aspekti administrative dhe teknik për të vlesuar se oferta e opratorit ekonomik është e sukseshsme apo e pasuksseshme. Andaj, pretendimi ankimor I operatori ekonomik ankues është i bazuar.

Shembull: Në tabelën më poshtë kemi paraqitur në formë tabelare kalkulimin e çmimeve, respektivisht se si ish dashur të llogaritej oferta financiare OE EL POWER & AL FOCUS 7:

Projekti i Zhvillimit të Transmisionit të Kosovës

Përmbledhja e madhe

Nr.	Përshkrimi	Çmimi në total DDP EURO	ndërtimi / ngritja / vënja në funksion EURO	TVSH 18%	Kostoja totale EURO	[illegible]	[illegible] EURO
		A	B	C=(A+B)x18%	D=A+B	[illegible]	[illegible]
1.	Programi 1: Dizenjimi, furnizimi dhe instalimi i impiantit dhe pajisjeve përfshirë pjesët e datyrueshme të rezervës	1,265,200.00	51,700.00	237,042.00	1,316,900.00	[illegible]	[illegible]
2	Programi 2: Dizenjimi dhe Ndërtimi i Punëve Inshinierike	102,000.00	9,200.00	21,816.00	121,200.00	[illegible]	[illegible]
			Çmimi pa TVSH		1,438,100.00	Çmimi pa TVSH	[illegible]
			TVSH		258,858.00	TVSH	[illegible]
			Çmimi TVSH		1,696,958.00	Çmimi TVSH	[illegible]
			Si ka vepruar OE EL POWER			[illegible]	

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues –teknik konstaton se se operatori ekonomik EL POWER&AL FOCUS 7 në listen e përshkrimit të çmimeve, normën e TVSH-së e ka aplikuar dy herë, nese TVSH-ja është më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës, nuk konsiderohet si gabime aritmetikore, sipas KRPP-së Ndimesë- pyetjete e shpeshta pika 46 thuhet:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Andaj, Pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE EL-POWER & AL FOCUS 7 ka deklaruar se posedon Menaxherin e projektit me pervojë pune mbi 5 vite, por **nuk ka deklaruar se ka pervojë të natyrës së ngjajshme**, si dhe nuk ka ofruar asnjë deshmi si diploma, kontrata e punës dhe referencat për menaxhimin e projekteve të realizuara. Në këtë rast pasi nuk e ka konkretizuar kush është Menaxheri I projektit deklarata është e thatë dhe pasubjekt.

Paneli shqyrtues conform eksperiti shqyrtues –teknik konstaton se operatori ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 në oferten e tij ka ofruar deklarte për projek menaxher , por nuk ka ofruar ndonje CV apo Diplome për projekt menaxherin. Andaj, pretendimi ankimore I operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Referencat e natyrës së ngjajshme jane per furnizim dhe montim te transformatoreve 110 kV, ndersa mungon referenca per energjizim te transformatoreve 220 kV si dhe nuk ka dëshmuar se ka ndërtuar themele/bazamente të transformatorëve 110 kV dhe 220 kV në tri vitet e fundit.

Paneli shqyrtues conform Ekspertit shqyrtues konstaton se operatori ekonomik EL-POWER & AL FOCUS 7 ne oferten e tij ka ofrur Referenca e natyrës së ngjajshme për furnizim dhe montimin e transformatoreve 110kV, ndërsa për transformatoreve 220 kV, në oferten e tije ka ofruar vetëm kontratën por jo Referencat.

Po ashtu autoriteti kontraktues kërkese për rishqyrtimi të operatorit ekonomik ankues nuk e ka shqyrtuar as një pretendim ankimor. Autoriteti kontraktues ka vepuar në kundershtim me Neni 108/A pragrafi 12. Duke nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesë për rishqyrtimi pa analizuar as një pretendim ankimor të parashtruar nga operatori ekonimk ankues.

Paneli shqyrtues ne vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE "EL-Power & AL-Focus" LOT 4

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Grupi ynë i Operatoreve Ekonomik EL-POWER, AL FOCUS7 sh.p.k jemi njoftuar nga AK se oferta (tenderuesi) i pasuksesshëm për tenderin ne fjale, pa te drejte, ne mënyrë jo objektive dhe jo ligjore për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te drejte te gjendjes faktike si dhe shkeljes se dispozitave ligjore nga ana e AK Oper.Sistemi,Trans, Dime Trgu KOST SHA, kështu qe duke u bazuar ne këtë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin tone është plotësisht i padrejte, jo objektiv dhe i shoqëruar me shkelje, ligjore, ku janë shkelur ne tërësi dispozitat e Ligjit te Prokurimit (LPP-s)Nr.04/L-042 si dhe dispozitat e RRUOPP-secilat i precizojmë si me poshtë.

Paneli shqyrtues konform eksperitti shqyrtues sqaron se bazuar ne letrën standarde për njoftim te tenderuesit (B46), operatori ekonomik ankues është kualifikuar si tenderues i pa suksesshëm. Pra oferta e OE ankues nga komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues nuk është eliminuar siç thekson OE ankues. Nuk është rekomanduar për kontrate ne LOT 4 për shkak te çmimit me te lartë te ofertës ne raport me operatorin ekonomik fitues. Pra nuk qëndron pretendimi se oferta e OE është eliminuar, oferta ka qene e pasuksesshme. Ne ankesën e OE ankues e cila është e ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi nuk është theksuar asnjë pretendim tjetër dhe nuk është përmendur asnjë nen apo dispozite e LPP-së, e cila është shkelur nga AK. Pra ankesën te cilën e ka shkarkuar eksperti shqyrtues nga sistemi elektronik është e mangët dhe pa asnjë dëshmi apo pretendim për shkelje te LPP-së.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me pretrendimet ankimore te OE "Electra" LOT 3

